- Mekanizmi i Balancimit
- Prokurimi i Shërbimeve Ndihmëse
- Njoftimi i Kontratave
- Menaxhimi i të dhënave energjitike

➤ Moduli i Ankandeve të Kapacitetit


Në këtë modul realizohet ankandi mujor i alokimit të kapaciteteve me kufirin me Kosovën, përkatësisht operatori skedulon kapacitetet e lira për alokim dhe time line për zhvillimin e ankandit. Bazuar në këtë time line zhvillohet procesi dhe rezultatet. Gjithashtu në këtë modul kemi dhe të dhënat e ankandeve për kapacitetet për kufijtë e tjerë që zhvillohen në SEECAO.



➤ Moduli i Skedulimit Ndërkufitar


- Cross-border scheduling overview – Monitoron të gjitha nominimet e pjesëmarrësve të tregut sipas kufijve.
- Cross-border scheduling Form – Krijon një skedulim në kufijtë (ME,RS,GR).

- Cross-border Balance –Monitorim/kontroll i programit të shkëmbimit (Balanca e sistemit).
- CAS Matching Overview – Monitoron përputhshmerinë e CAS, në rast gabimi duhet të identifikohet ku mund të jetë papajtushmeria.
- CBS Matching Overview – Monitoron përputhshmerinë e CBS, në rast gabimi duhet te identifikohet ku mund të jetë papajtushmeria.
- Schedules upload (XML) - Upload i skedulave në XML në rastet kur pjesëmarrësit e tregut nuk kanë mundësi aksesimi nga platforma e vet, ju jepet suport nëpërmjet dërgimit nga ana e tyre të skedulimit me email.
- Matching File Upload – Upload manualisht dokumenti (CAS, ACK, CNF) në rastet kur ka problem me mail serverin e DAMAS.
- SAX Matching Overview –Kontrolli pas mbylljes së programeve ditore dhe brenda ditës me kufijtë.




➤ CONTRACT NOTIFICATIONS (Njoftimi i Kontratave)

- Generation Schedule Form – Bëhet deklarimi/skedulimi i transaksioneve nga pjesëmarrësit e tregut si dhe gjenerimi nga Hec-et ,konsumi i tyre.
Generation Schedule Overview – Jep informacion rreth vlerës së nominuar nga çdo PPB (për prodhimin (Production – sipas çdo njësie Gjeneruese) si dhe për konsumin (Virtual Load – sipas kontratave përkatëse të furnizimit me Energji Elektrike).



➤ INTERNAL SCHEDULING (Skedulimi i Brendshëm)


- Internal Schedules Overview – Monitorohet skedulimi i deklaruar nga pjesëmarrësit e tregut në DAMAS.
- Internal Schedule Form – Krijimi i një skeduli të ri për transaksionet në rrjetin e brendshëm në rastin tonë për OST (skedulimi i humbjeve).
- Internal Matching Overview – Shikojmë përputhshmërinë e skedulimit të tregtarëve për rrjetin e brendshëm.
- Schedule upload (XML) – Shërben për të përcjell file XML, i cili bëhet upload nga skeduluesi në sistem.
- Balance Overview – Monitorohet balanca e sistemit për të gjithë tregtarët për një periudhë të caktuar.



➤ ADMINISTRATION CONSOLE (Paneli i Administrimit)

- Process Schedules (Skedulimi i Proceseve)

- Daily process for border---Daily nomination process – (Proceset ditore për çdo kufi, proceset ditore të nominimit)
- Daily Processes.(Proceset Ditore)
- Cross Border Metering Process – Long term, daily, intraday.(Procesi i matjeve në kufi, në afatgjatë, ditor dhe brenda ditës)
- Report Process – Monitorohet matching e SAX file.
- Internal Scheduling – Monitorohet procesi i skedulimit të brendshëm.



➤ Moduli i Llogaritjes së Energjisë në kufi

Moduli i “Llogaritjes Së Energjisë Në Kufi” është modul funksional dhe në operim në bazë ditore. Ky modul është konceptuar konform policës 2 të ENTSO-E si dhe bazuar në marrëveshjet bilaterale me OST-të kufitare:

- Procesi i Llogaritjes së Energjisë në kufi – Zhvillohet procesi 'Accounting' pasi vijnë të dhënat nga matjet krijohen SOMA, SOAM, SOVA.
- Metering Data Overview – Monitoron të dhënat në sistem që vijnë nga sistemi i matjes ENTSO MVD File.
- Metering Data Form – Vendosi manualisht e të dhënave nga sistemi i matjes.
- Accounting/Settlement Data Overview –Monitoron SOMA, SOAM, SOVA që të jetë në harmonizim me kufirin tjetër.
- Accounting Settlement Data upload – Shërben për të dërguar në sistem skedat SOMA, SOAM, ACK COMPENSATION në rast se ka problem aksesimi me mail server.

The screenshot shows a web interface for the DAMAS system. It features three filter sections: 'Schedule' with a dropdown menu set to 'Daily processes', 'View' with a dropdown menu set to 'Accounting Daily Processes', and 'Day (CET)' with a date input field showing '3.3.2020' and navigation arrows. A red 'Show data' button is positioned to the right of the filters. Below the filters, a summary table displays the selected values: 'Schedule' as 'Daily processes', 'View' as 'Accounting Daily Processes', and 'Day (CET)' as '3.3.2020'.

Filter	Value
Schedule	Daily processes
View	Accounting Daily Processes
Day (CET)	3.3.2020

➤ Moduli i Shërbimeve Ndhmëse

Moduli i shërbimeve ndihmëse dhe kontratave mundeson prokurimin e shërbimeve ndihmëse (rezerves rregulluese primare, sekondare dhe terciare).


Objektivat kryesorë të modulit të shërbimeve ndihmëse dhe kontratave janë:

- Blerja e sasisë së mjaftueshme të Shërbimeve Ndhmëse përmes tenderëve
 - Rezervat primare sekondare dhe terciare
- Krijimi i kontratave për ofrimin e shërbimeve ndihmëse

Tenderi mund të krijohet për një ose më shumë kategori të mëposhtme të shërbimeve ndihmëse:

- Rezerva Primare
- Rezerva Sekondare (band) (RSB)
- Rezerva Terciare e Shpejtë (vetëm pozitive) (RTR)
- Rezerva e ngadaltë terciare (vetëm pozitive) (RTL)
- Humbjet e Transmetimit në Rrjet


Ky modul shërben për prokurimin e Energjisë për mbulimin e Humbjeve në treg, një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente. Përkatësisht operatori skedulon në platformë kërkesën dhe Time Schedule të tenderit, në baze të të cilit platforma proceson rezultatet.



➤ Moduli i Mekanizmit të Balancimit

Ky modul do të shërbejë OST për prokurimin e energjisë balancuese (kapacitetit rezervë) (Primar, Sekondar, Terciar) në tregun balancues në mënyrë që të sigurohet balancimi dhe siguria e operimit të sistemit energjitik kombëtar.

Tregu balancues është një treg vetëm me një blerës OST. Palët e licensuara të cilat do të operojnë në këtë treg janë të detyruara dhe duhet të jenë të kualifikuara për të ofruar energjinë balancuese sipas rregullave në fuqi.



2 SHËRBIMET E KERKUARA

Në këtë paragraf përcaktohen të gjithë shërbimet e nevojshme që duhet të ofrohen për të garantuar një mirëmbajtje sa më efikase të platformës DAMAS si dhe kërkesat e nevojshme mbi zhvillimin dhe përmirësimin e moduleve të kësaj platforme. OST sh.a. është përgjegjëse për operimin e platformës DAMAS si dhe për mirëmbajtjen bazë të kësaj platforme. Mirëmbajtja e avancuar e platformës do të garantohet nëpërmjet këtij shërbimi. Shërbimet e nevojshme për mirëmbajtje të avancuar janë të kategorizuara sipas dy grupeve:

1. Shërbimet për mirëmbajtje dhe përditësim të funksioneve të DAMAS
2. Shërbimet për Infrastrukturën hardware-ike

Aktivitetet lidhur me zhvillimin dhe përmirësimin e Platformës DAMAS janë si më poshtë:

1. Rikonceptimi i Modulit të Transparencës.
2. Implementimi i një Ndërfaqeje mbi raportimin e të dhënave të DAMAS
3. Sinkronizimi i Platformës Production me atë Test
4. Organizimi i Modulit të Balancimit konform me rregullat e ERE
5. Automatizimi i Modulit të Llogaritjes së Energjisë në Kufi
6. Përmirësimi i “Process Schedule“
7. Implementimi i DashBoard mbi kontrollin e proceseve
8. Rikonceptimi i Modulit të Sherbimeve Ndhimese dhe Kontratave

Krahas aktiviteteve të përmendura më sipër, në këtë projekt do të parashikohen disa aktivitete opsionale (që nënkupton që do të zhvillohen në rast se do të jetë e nevojshme gjatë kohëzgjatjes së kontratës). Lidhur me këto aktivitete, kontraktori nuk do të fillojë aktivitetin pa patur një kërkesë për zhvillimin e një aktiviteti të caktuar. Në rast se nuk do të jetë e nevojshme që këto aktivitete opsionale të zhvillohen, këto aktivitete nuk do të faturohen. Këto aktivitete janë :

1. Konfigurimi i Zonës së Kontrollit të KOSOVES si pjesë e bllokut AL
2. Konfigurimi i një kufiri të ri energjitik

Lidhur me zhvillimet e kërkuara kontraktori duhet të paraqes në OST sh.a. projektin teknik për secilin nga këto zhvillime. Në vijim të miratimit të këtyre projekteve nga ana e OST sh.a., kontraktori duhet të vijoje me implementimin dhe më pas të organizohet testimi bashkërisht me ekipin nga OST sh.a. Kontraktori duhet të dorëzojë dokumentacionin „as built“ lidhur me zhvillimin e sistemit DAMAS, ku krahas projektit teknik (functional design) të paraqesi manualin e operimit, skenarët e testimit (të cilët gjithashtu duhet të aprovohen nga OST sh.a para realizimit të testeve) si dhe raportet e testimit për çdo zhvillim.

2.1 Shërbimet për Mirëmbajtjen e Platformës DAMAS

Infrastruktura e Platformës DAMAS është e instaluar në zyrat qendrore të OST sh.a. Shërbimet e nevojshme në kuadër të mirëmbajtjes së avancuar përfshijnë pjesën e infrastruktures si dhe pjesën aplikative të instaluar dhe në përdorim nga OST sh.a.

Kontraktori duhet të japë shërbimet e suportit që nevojiten për të menaxhuar mirëmbajtjen periodike dhe gjithashtu kushtet e paparashikueshme, të degraduara ose dhe emergjente të bazës së instaluar.

Shërbimi i mirëmbajtjes mund të ofrohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) onsite – 'suportit' jepet në zyrat e OST, i shoqëruar nga specialist;
- b) offsite apo online në distancë – 'suportit' do jepet nga distanca duke i dhënë akses me VPN, por i monitoruar deri në përfundim të punës ose duke dhënë akses remote të PC e specialistit

(p.sh. webex), më pas të aksesojë infrastrukturen e Damas duke u regjistruar e gjithë periodha e akses në distancë.

2.1.1 Funksionet e Sistemit DAMAS

Sistemi DAMAS ka të integruar disa module funksionale të automatizuara, bazë mbi të cilën operon i gjithë sistemi. Këto module (të listuara në kapitullin 1 të këtij dokumenti) janë të ndërlidhura mes tyre në mënyrë që të mundesojnë operimin e të gjitha funksionaliteteve të operimit të Tregut.


Lidhur me këto module software-ike kontraktori duhet të kontrollojë gjendjen e tyre dhe të raportojë OST sh.a. mbi këtë gjendje. Raportimi do të bëhet sipas raporteve të rakorduara nga dy palët si dhe nëpërmjet logeve të secilit prej moduleve. Bazuar në loget, kontraktori dhe OST do të investigojnë mbi çdo rast anomalie. Anomalitë mund të kategorizohen në dy grupe, në anomali të cilat nuk afektojnë operimin nëpërmjet software-it si dhe anomali të cilat ndikojnë në mënyrë direkte në operimin e sistemit ose limitojnë disponueshmërinë e funksionaliteteve. Në rastin e anomalive që nuk afektojnë operimin OST dhe kontraktori duhet të vendosin mbi hapat që do të ndërmerren në vijim. Në rastin e anomalive që afektojnë operimin nëpërmjet sistemit, kontraktori duhet të ndërhyjë menjëherë për të analizuar modulën e dëmtuar dhe të rikthejë atë në gjendje funksionale. Anomalitë, krahas kontroleve periodike mund të evidentohen nga specialistët e OST sh.a., të cilët duhet të njoftojnë kontraktorin.

SHERBIMET E NEVOJSHME SOFTWARE		NIVELI
Kontrolle periodike te gjendjes së moduleve funksionale dhe raportimi mbi këtë gjendje:		
1	- Moduli Ankandeve të Kapacitetit - Moduli i Skedulimit - Moduli i Llogarritjes së Energjisë në kufi - Moduli i Shërbimeve Ndihmëse - Moduli i Mekanizmit të Balancimit	2
2	Rikuperimi i dështimeve software dhe rikthimi i tij në gjendje normale pune	2

Shërbimi i Mirëmbajtjes

Ky dokument është një propozim për shërbimin, që ka si qëllim mirëmbajtjen dhe mbështetjen e Sistemit DAMAS. Shërbimi përfshin dhe riparimin e çdo defekti, i cili mund të ndodhë gjatë operimit të këtij sistemi nga OST sh.a. apo palë të treta, të cilat përdorin këtë sistem. Përgjegjësia kryesore e ekipit të Mirëmbajtjes dhe Mbështetjes (M&S - Maintenance and Support) është për të mbajtur sistemin në kushte operative. Gjithashtu, M&S mund të ofrojë përmirësime të vogla në sistem (me marrëveshje).

Mbështetja do të sigurohet sipas skemës së mëposhtme:



Model për Mirëmbajtje dhe Support

në Mbështetje të Nivelit të Parë (helpdesk, duke siguruar kontakt të drejtpërdrejtë me përdoruesit përfundimtarë të Sistemit) Në Sistemin e Raportimit të Problemeve ndjek të gjitha të dhënat e dërguara nga përdoruesit.

Të gjitha inputet e marra nga Mbështetja e Nivelit të Parë, janë dorëzuar në **Mbështetje të Nivelit të Dytë** - kjo është pjesa kryesore e shërbimit M & S, nga pikpamja e operatorit. Mbështetja nivelit të dytë propozohet të ofrohet në disa mënyra, duke përfshirë shërbimin Hotline. Mbështetja e Nivelit të Dytë ka disa qëllime - ajo parandalon paraqitjen e çështjeve (Mirëmbajtje Parandaluese), zgjidhjen e incidenteve (Menaxhimi i Incidenteve) dhe problemeve (Menaxhimi i Problemeve), Çështja kalon te **Mbështetja e Nivelit të Tretë**, në ato raste kur çështja kërkon njohuri të thella për zhvillim SË.

Një përshkrim më i hollësishëm i këtyre proceseve është në dispozicion më poshtë. Mbështetja e Nivelit të Dytë gjithashtu ofron mbështetje SPOC për OST sh.a dhe është përgjegjëse për shtrirjen e të gjitha shërbimeve të ofruara. Mbështetja e Nivelit të Tretë ka të drejtë të zgjidhë defekte duke përdorur elemente të përbërë nga palët e treta .

Trajtimi i Çështjeve Mbështetëse

Të gjitha çështjet e identifikuar duhet të raportohen me telefon, email ose duke krijuar një hyrje në Sistemin e Raportimit të Problemeve. Nëse çështja nuk është raportuar direkt me sistem, ekipi i M&S do të regjistrojë çështjen vetë.

Tipet bazë të çështjeve që do trajtohen janë: Incidentet / Problemet / Kërkesat e Shërbimit / Kërkesat për Ndryshim. Për çdo tip , përcaktohet një proces specifik. Në menutë (ëorkfloës) themelore për secilin tip çështjeje përfshihen këto faza: monitorimin & rishikimin / identifikimin / analizën/ vlerësimin / zbatimin e veprimit.


Menaxhimi i Incidenteve

Qëllimi i procesit Menaxhimi Incidenteve është për të rivendosur funksionimin standart të shërbimit sa më shpejt të jetë e mundur dhe për të minimizuar ndikimin negativ të incidenteve në funksionimin e sistemit. Pas zgjidhjes së incidentit personeli i M&S mund të merret me identifikimin dhe zgjidhjen e shkakut të incidentit. Pas identifikimit të incidentit, dhe shkakut, operatori ekonomik duhet të dërgojë një raport te OST sh.a.

Një incident i raportuar është një ndërprerje e paplanifikuar e funksionimit normal (devijim nga nivelet e pritura të shërbimeve). Menaxhimi i Incidenteve është procesi për trajtimin e menjehershëm të gjitha incidenteve, duke përfshirë edhe dështimet e raportuara nga përdoruesit e thjeshtë të sistemit, nga stafi teknik ose të zbuluara dhe raportuara automatikisht nga mjetet monitoruese të sistemit. Menaxhimi i incidentit sigurohet me Mbështetjen e nivelit të dytë.

Menaxhimi i Problemeve

Qëllimi i procesit të Menaxhimit të Problemeve është të identifikojë, në përputhje me rrethanat, për të zgjidhur shkaqet rrënjësore të incidenteve dhe në këtë mënyrë të zvogëlojë numrin e incidenteve të papritura dhe të panjohura në të ardhmen. Procesi i Menaxhimit të Problemeve minimizon numrin dhe ashpërsinë e incidenteve dhe problemeve. Në vazhdim ky problem raportohet si "gabim i njohur", dhe i vihet në dispozicion dhe OST sh.a. Identifikimi paraprak bën të mundur zgjidhjen e problemeve para se incidentet të ndodhin.



Menaxhimi Problem

Termi "Problem" i referohet shkakut themelor të panjohur të një ose më shumë incidenteve. "Gabim i njohur" është një problem që është diagnostikuar me sukses dhe për të cilin është identifikuar një punë ose një zgjidhje e përhershme. Ndryshimet që mund të rezultojnë mund të jenë një input për menaxhimin e ndryshimit dhe realizimit. Menaxhimi i problemeve propozohet të sigurohet nga Mbështetja e Nivelit të Dytë.

Menaxhimi i Njohurive

Të përfshihet menaxhimi i njohurive, si pjesë e menaxhimit të problemit, për të reduktuar rastet kur përdoruesit e sistemit shkaktojnë të njëjtin problem dhe e dërgojnë te S&M për zgjidhje. Prandaj propozohet që të vendosen në dispozicion të stafit OST sh.a në portalin Sistemit të Raportimit të Problemeve ose në Menunë "Help" të Sistemit DAMAS gjithë informacioni lidhur me Problemet dhe Incidentet e njohura.

Menaxhimi i Kërkesave

Brenda kërkesave të shërbimit, OE do të trajtojë gjithçka që është dakorduar dhe pranuar reciprokisht. Kjo zakonisht do të thotë:

- Mbështetja e përdoruesit: Një kërkesë për mbështetjen e përdoruesit, informacion, konsulencë, trajnim ose dokumentacion shtesë.
- Shërbimi Standard: Procedurë e paracaktuar (të jetë pjesë e katalogut të shërbimeve), që do të ekzekutohet nga S&M pa asnjë miratim shtesë. Një shërbim standard / ndryshim është një veprim i autorizuar paraprakisht, që është me rrezikshmëri të ulët, relativisht i zakonshëm, dhe ndjek një procedurë ose udhëzim pune.

Menaxhimi i Ndryshimeve

Të gjitha ndryshimet do të regjistrohen dhe trajtohen pavarësisht nga lloji i tyre në sistemin e biletave. Kjo do na sigurojë një informacion të konsoliduar për natyrën e çdo ndryshimi dhe një vlerësim për pasojat e çdo ndryshimi, midis tyre informacioni lidhur nëse pasojat ndikojnë

vetëm në mirëmbajtje/ update versioni / apo në zhvillimin e sistemit. Gjithashtu nëse do të preken komponentë apo/ edhe sistemeve të palëve të terta, që janë integruar ose lidhur në sistemin DAMAS nga ndryshimet, OST sh.a duhet të vendoset në dijeni lidhur me të gjitha proceset e ndjekura.

Për më tepër, për të gjitha ndryshimet komplekse, S&M duhet ti ofrojë një raport OST.sh.a, për të njoftuar edhe palët e treta për ndikimet që do kenë në sistemet e tyre.

Menaxhimi i shkarkimeve (Release) është proces i instalimit dhe konfigurimit, që punon me mbështetjen e Menaxhimit të Ndryshimit për të ndërtuar, testuar dhe instaluar shërbime të reja ose të përditësuara në platformë.

Të gjitha aktivitetet e S&M duhet të lenë gjurmë dhe të rregjistrohen (logs) në cdo moment. Menaxhimi i ndryshimit propozohet të sigurohet nga Mbështetja e Nivelit të Dytë.


Raportimi

Të zhvillohen raporte të ndryshme lidhur me zhvillimet e S&M, takime fizike ose në formën e telekonferencës.

Të gjitha incidentet dhe problemet duhet të ngrihen dhe ndiqen në Sistemin e Raportimit të Problemeve, në këtë mënyrë, OST sh.a do ketë mundësinë të monitorojë në "kohë reale" ecurinë dhe progresin e zgjidhjes së problemeve. Në këtë rast OST sh.a mund të monitorojë, të njohë vazhdimisht statusin e sistemit, dhe të raportojë.

Parametrat SLA duhet të monitorohen gjatë gjithë kohës së ofrimit të shërbimit, dhe përmbushja e tyre do të vlerësohet nga OST sh.a në baza të rregullta mujore.

OST sh.a merr Raportin e Shërbimit të Mirëmbajtjes, në bazë të të cilit do vlerësojë cilësinë dhe nivelin e shërbimeve të ofruara. Raporti i Shërbimit është një nga rezultatet kryesore të S&M. Ky raport do na shërbejë si provë e cilësisë së mbështetjes dhe mirëmbajtjes së ofruar.



Raporti i Shërbimit

Për strukturën e raportit sugjerohet të përdorë një template standard. Ky model raporti duhet të përmbajë kryesisht vlerësimin e parametrave SLA dhe dokumentacionin në detaje të aktiviteteteve e kryera brenda shërbimit gjatë periudhës së mëparshme (si e parashikuam me lart, gjatë muajit të kaluar):

- Vlerësim të rregullt të kryerjes së shërbimit, që do na sigurojë të gjithë informacionin për shërbimin si në tërësi dhe komponentë të veçantë të shërbimit.
- Përbushja e SLA dhe prishja, duke përfshirë kohën e përgjigjes dhe zgjidhjes.
- Disa bileta për kategori, duke përzgjedhur kategoritë kryesore.
- Incidentet dhe problemet më të rëndësishme.
- Lista e përmirësimeve.
- Lista e riskut dhe veprimet zbutëse.
- Rishikimi i vazhdueshëm i shërbimit dhe parashikim të përmirësimit të dhe shërbimit.

2.2 Zhvillimi dhe përmirësimi i Platformës DAMAS

2.2.1 Rikonceptimi i Modulit të Transparencës.


Platforma e Transparencës ka si qëllim publikimin e të dhënave bazike të cilat përcaktojnë gjendjen aktuale të sistemit. Kjo platformë është ngritur në bazë të rregullores Nr 543/2013 të 14 Qershor 2013 mbi dërgimin dhe publikimin e të dhënave në tregun e energjisë. Nëpërmjet kësaj rregulloreje cdo OST pjesë e rrjetit europian të OST-ve duhet të dërgojë dhe publikojë të dhënat mbi Ngarkesën, Gjenerimin, Transmetimin, Balancimin, Operimin e Sistemit etj. Publikimi i të dhënave në këtë platformë kërkon përbushjen e dy kushteve kryesore:

- Respektimi i formatit dhe skemës së organizimit të të dhënave
- Respektimi i arkitekturës dhe protokollit mbi të cilën operon kjo platformë.

Gjendja Aktuale

Në sistemin DAMAS është implementuar moduli i transparencës nëpërmjet komponentit ETP Connector. Ky modul merr të dhëna të cilat duhen publikuar nga sistemi DAMAS dhe sisteme të tjera të OST, i transformon në formatin e kërkuar XML dhe i dërgon nëpërmjet protokollit ECP drejt platformës së transparencës.

Skema e përgjithshme konceptuale e komunikimit është si më poshtë:



Në nivel aplikativ ky funksion nuk ofrohet nëpërmjet një moduli të veçantë në platformë. Përgatitja e një raporti dhe dërgimi i tij realizohet nëpërmjet disa proceseve në Ndërfaqen

Administration Console/ Process Schedule. Cdo proces në këtë ndërfaqe është përgjegjës për krijimin e një raporti sipas formatit të kërkuar dhe dërgimin drejt Platformës së Transparencës. Procese të ndryshme shfaqen si output i aplikimit të filtrave të ndryshëm në këtë ndërfaqe. Sistemi nuk ofron një ndërfaqe të dedikuar e cila të përmbajë të gjitha proceset përgjegjëse për krijimin dhe dërgimin e raporteve drejt platformës së Transparencës.

Zhvillimet e kërkuara

Qëllimi i këtij nënmoduli:

- Të ofrojë një mënyrë paraqitjeje më të mirëorganizuar, lehtësisht të kuptueshme dhe të identifikueshme në rastin e dërgimit të vlerave të gabuara drejt platformës së transparencës.
- Të ofrojë mundësinë e hedhjes manuale të të dhënave në rastin e dështimit të proceseve automatike. Pra të ofrohet gjithmonë një mënyrë ‘backup’ manuale dhe të sigurohet dërgimi koherent dhe i saktë i të dhënave drejt platformës së transparencës.

Në këtë modul duhen aplikuar përmirësime në dy nivele:

- Nivel ndërfaqësimi
- Nivel funksional

Përmirësimet e kërkuara sipas secilit nivel jepen si më poshtë:

Nivel Funksional


- Platforma duhet të japi mundësinë e marrjes së të dhënave nga disa burime. Të dhënat mund të merren :
 - Nga procese automatike por që kanë dhe mundësinë e riplanifikimit/ristartimit manual nga përdoruesi me të drejtat e Ofruesit të të dhënave për platformën e transparencës
 - Nga useri duke hedhur të dhënat manualisht në format tabelare(Nënmoduli Raportet)
 - Të uploadohen manualisht file xml (Manuale)
- Cdo raport duhet konfiguruar sipas skemës XDS përkatëse të ofruar nga ENTSO-E dhe configuration matrix.
- Instalimi i Protokolli i komunikimit ECP v4 (Energy Communication Protocol) i cili sipas standarteve dhe rregullave të ENTISOE duhet të përdoret për dërgimin e të dhënave drejt platformës së transparencës.

- Komunikimi i sistemit DAMAS me sisteme të tjera si sistemi SCADA apo sistemi i matjes për të marrë të dhëna të cilat nuk sigurohen dot nga vetë proceset e sistemit DAMAS. Këto sisteme shërbejnë si burim informacioni për popullimin e raporteve të transparences.
- Platforma duhet të realizojë identifikimin dhe dallimin e rastit kur nuk kemi hedhur të dhëna dhe të rastit kur këto të dhëna janë në vlerën sasiore 0. Pra duhet realizuar dallimi në nivel sistemi i vlerave të mëposhtme:
 - Zero cilësore (mungesa e ofrimit të një vlere) – N/A (not available)
 - Zero sasiore – kur kemi vlerë 0 të një të dhëne
- Moduli duhet të pranojë disa versione të një raporti në rastin e ridërgimit të tij
- Validimi i raportit ku të identifikohet erroret në nivel
 - Sintakse
 - Skeme xsd
 - Logjike si rezolucioni kohor
- Platforma test duhet të konfigurohet si një Endpoint i cili duhet të dërgojë të dhëna drejt platformës test të Transparencës.
- Dhënia e aksesit në modulën/komponentit ETP connector (server tomact me service)
- Krijimi i një maske/roli të ri – Transparency Data Provider i cili duhet krijuar për të pasur të drejtën e aksesimit vetëm tek ky modul.

Nivel Ndërfaqësimi

- Të ofrohet një ndërfaqe lehtësisht e përdorshme (user friendly)
- E mirëorganizuar dhe lehtësisht e kuptueshme
- Organizimi në nënmodule
- Të dhënat të jenë lehtësisht të aksesueshme

Menuja përgjegjëse për Platformën e Transparencës e cila do të shtohet në sistemin DAMAS duhet të ketë paraqitjen e mëposhtme:



Të gjitha përmirësimet e lartpërmendura të organizuar në dy nivle do të arrihen duke aplikuar specifikimet e organizmit të këtij moduli si më poshtë:

Moduli i Transparencë duhet të konfigurohet si një modul më vete në platformën DAMAS, i cili duhet të aksesohet nëpërmjet menuse e cila shfaqet në ndërfaqen kryesore të sistemit. Ky modul duhet të përbëhet nga 3 nënmodule ose 3 ndërfaqe në sistem të cilat përfaqësojnë funksionalitete bazike mbi gjenerimin, kontrollin dhe dërgimin e këtyre raporteve drejt platformës së transparencës. Këto 4 nënmodule janë:

1. Raportet
2. Manual File Upload
3. Data Floë

Gjithashu në këtë dokument është specifikuar dhe se si do të organizohen dhe ekzekutohen proceset funksionale të cilat janë përgjegjëse për dërgimin e raporteve drejt platformës së transparencës. Ky përshkrim teknik duhet aplikuar në pikën 2.2.7 Implementimi i Dashboard mbi kontrollin e procesve të specifikimeve teknike.

Më poshtë gjeni karakteristikat e secilit nënmodul.

2.2.2 Raportet

Kjo ndërfaqe duhet të përmbajë të gjitha raportet të cilat nisen drejt platformës së transparencës të organizuara në kategori. Kategoritë janë si më poshtë:

- Ngarkesa
- Gjenerimi
- Transmetimi
- Balancimi
- Remontet
- Menaxhimi kongestionit
- Operimet e Sistemit (Marrëveshjet)

Raportet të organizuara sipas kategorive duhet të shfaqen në formë tabelare ku të jetë e mundur leximi i të dhënave cilat po nisen drejt platformës së transparencës. Paraqitja tabelare e këtyre raporteve duhet të ketë si kolona të gjitha vetitë/karakteristikat përkatëse të secilit raport. Ndërsa rreshtat duhet të përkohet me rezolucionin kohor përkatës, të kërkuar të cdo raporti.

Kjo ndërfaqe duhet të ketë opsionin e filtrimit të raporteve në bazë të kohës. Duhet siguruar që filtri i kohës të përkohet me rezolucionin kohor të raportit.

Për shembull: Nëse kemi raportin “Total Load Forecast -Month Ahead” atëherë do të shfaqet një kalendar i cili filtron sipas muajve dhe nëse kemi një raport me rezolucion javor(Total Load Forecast – Week Ahead”) do të kërkohet kalendar javor.

Ky opsion mundëson navigimin në kohë të raporteve të nisura drejt platformës së transparencës dhe shërben dhe si një arkiv për ruajtjen e këtyre të dhënave.

Opsione të tjera të cilat duhet të ofrojnë kjo ndërfaqe është edhe mundësia e editimit të të dhënave të cilat nisen drejt platformës së transparencës. Ky është një opsion i cili mundëson hedhjen manuale të të dhënave në rastin e dështimit për arsye të ndryshme të proceseve automatike përgjegjëse të sistemit. Ky është një opsion kryesor i ndërfaqës pasi ofron një përmirësim funksional të modulit.

2.2.3. Manual File Upload

Ky nënmodul duhet ti ofrojë userit më rol “Transparency Data Provider” mundësinë e uploadimit të fileve xml dhe dërgimin e tyre drejt platformës së transparencës.

Pas dërgimit kjo ndërfaqe duhet të sjelli një konfirmin të dërgimit të fileve.

2.2.4 Data Flow

Ndërfaqja Data Flow duhet tju ofrojë përdoruesve me të drejta “Transparency Data Provider” dhe “Administrator” një pamje të përgjithshme monitoruese të të gjitha raporteve .xml të cilat nisen drejt Platformës së transparencës. Cdo mesazh .xml që niset drejt platformës së transparencës do të prezantohet nga një rresht në paraqitjen tabelare të kësaj ndërfaqeje. Atributet e secilit rresht (mesazh .xml) do të jenë si më poshtë:

- ID e Transferimit
- Data dhe koha e dërgimit sipas formatit UTC
- Burimi i të dhënës (Mund të marri këto vlera: Procesi ose Manual file)
- Emri i raportit i cili duhet të emërtohet në bazë të rregullores së dërgimit të të dhënave drejt platformës së transparencës
- Statusi :
 - Received
 - Processed
 - Rejected
- Emri i file(i klikueshëm dhe të shkarkohet në përgjigje të eventit të klikimit)
- ACK (të jetë e klikueshme dhe të shkarkohet si përgjigje e eventit të klikimit)

Në rastin kur në kolonën Status kemi vlerën “Rejected” të jëtë mundësia e ndërfaqësimit të arsyes së refuzimit të file. Ky opsion duhet të ofrohet me anë të një butoni i cili të çojë drejt një ndërfaqeje logesh. Ndërfaqja e logeve të Data Floë duhet të përmbajë të gjithë informacionin e

nevojshëm në lidhje me krijimin, procesimin dhe dërgimin e raporteve. Ky modul duhet të realizojë dedektimin e gabimit i cili mund të jëtë në nivel:

- Sintakse
- Nivel strukture xsd
- Logjik – mos repsektimi i rezolucionit kohor

Kjo ndërfaqe i vjen në nevojë userit pasi i ofron mundësinë e gjurimit dhe dedektimi ose identifikimit të hallkës e cila pengon dërgimin e raporteve drejt platformës së transparencës.

*Kjo ndërfaqe duhet të jetë e ngjashme me ndërfaqen ekzistuese “Data Transfer Overview” e cila gjendet nën modul “Administration Console”. Ndryshe nga kjo ndërfaqe ekzistuese ajo duhet të orojë një pamjet të përgjithshme të statusit të dërgimit, siç është specifikuar më lart dhe vetëm të raporteve të transparencës.

Dashboard i proceseve (process schedule) funksionale

Ky nënmodul nuk do jëtë një nënmodul i vecantë i modulit të Transparencës por ky koncept duhet aplikuar në pikën 2.2.7 Implementimi i Dashboard mbi kontrollin e procesve të specifikimeve teknike. Proceset përgjegjëse për përgatitjen dhe dërgimin e raporteve drejt platformës së transparencës duhet të jenë të organizuara sipas kategorive dhe rezolucionit kohor. Pra në këtë ndërfaqe duhet të jetë i mundur filtrimi i skedulës së proceseve në bazë të :

- Kategorisë :Ngarkesë, Gjenerim, Transmetim, Balancim, Remontet, Manaxhin i kongjestioneve.
- Rezolucionit kohor: ditor, javor, mujor dhe vjetor

Çdo proces duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:


- Të shfaqë kohën kur është planifikuar të ekzekutohet automatikisht
- Të ofrojë mundësinë e riekzekutimit/replan të procesit në rast se ky proces nuk ekzekutohet me sukses në kohën e planifikuar ose nëse ka pasur ndonjë dështim të proceseve të lidhura logjikisht me këtë proces.
- Të ofrojë një opsion i cili të dërgon në një ndërfaqe e cila paraqet të gjitha detajet e procesit. Specifikisht duhet të paraqiten të gjitha loget e ekezekutimit të procesit të cilat janë shumë të nevojshme në rastin e dështimit të ekzutimit të një procesi.

Gjithashtu në rastin kur gjenerimi i një raporti ka si kusht ekzekutimin me sukses të një procesi tjetër (pra kemi varësi procesesh) duhet të tregohet dhe statusi i ekzekutimit të këtij procesi. Ky opsion shërben për të lokalizuar dhe identifikuar problemin në rastin e dështimit të dërgimit të të dhënave.

Shembull: Ndërfaqësimi i procesit “Submit Scheduled Commercial Exchanges to ETP”

Ekzekutimi i këtij procesi duhet të shfaqet në 2 skema procesesh:


1. Në skemën Daily Process for Border (Proceseve Ditore per cdo kufi)




2. Proceset për ETP

Do të shfaqet edhe në nënkategorinë Administration Console/Process Schedules/Process Schedule for ETP.

Në këtë ndërfaqe do të shfaqet vetëm procesi i fundit “Submit Scheduled Commercial Exchanges to ETP” dhe pasi të klikohet në opsionin Detail të këtij procesi të shfaqet gjendja e procesit paraardhës. Kjo kërkesë është e nevojshme pasi ofrohet një ndërfaqe lehtësisht me e kuptueshme dhe e organizuar për përdoruesin më rolin “Transparency Data Provider”. Ky tip useri duke aksesuar vetëm process schedule e ETP të mund të kuptojë dhe identifikojë gabimin në rastin e dështimit të nisjes së të dhënave drejt transparencës. Në këtë rast nuk është e nevojshme që ky tip useri të ketë akses apo të kontrollojë në skemën e paraqitur në pikën 1 -> Daily Processes for Border.





2.2.2 Implementimi i një Ndërfaqjeje mbi raportimin e të dhënave të DAMAS

Bazuar nga operimi i funksionaliteteve që ofron sistemi DAMAS, një nga nevojat më të domosdoshme është raportimi i të dhënave të proceseve të realizuara. Aktualisht në sistemin DAMAS nuk ekziston një modul apo ndërfaqje më vete e cila të suportoje këtë funksion. Në ndërfaqjet e moduleve të ndryshme ekziston mundësia e ekstraktimit të disa raporteve të përcaktuara/të konfiguruara nga vetë sistemi në dy formate: CSV (excel) dhe PDF. Këto raporte të paracaktuara nuk paraqesin të gjithë të dhënat e proceseve dhe nuk mund t'ndryshohen. Për sa më sipër është e nevojshme implementimi i një ndërfaqjeje raportimi që do të ketë si objekt mbledhjen, formatimin dhe selektimin e të dhënave për raporte, analiza dhe publikime të ndryshme. Ky komponent duhet të ofrojë të dhëna të strukturuar në mënyrë që të suportojnë kërkesa të ndryshme analizimi dhe raportimi. Raportet të cilat do të aksesohen në këtë ndërfaqje duhet të pasqyrojnë të dhënat nga çdo modul aplikativ i sistemit DAMAS. Ndërfaqja mbi raportimin e të dhënave të DAMAS duhet të jetë një ndërfaqje e dedikuar për krijimin dhe gjenerimin e raporteve të ndryshme. Të gjitha raportet e ekstraktueshme nga kjo ndërfaqje duhet të përfshijnë të dhëna nga të gjitha modulet aplikative të sistemit DAMAS. Kjo ndërfaqje duhet të ndjeke një organizim funksional i cili do të suportoje si më poshtë:

- Gjenerimin dhe ekstraktimin e raporteve të paracaktuara nga sistemi
- Ekstraktimin/shkarkimin e raporteve në disa formate: excel dhe pdf
- Marrja e të dhënave nga të gjitha modulet e sistemit DAMAS
- Përdorimin e një tool (mjeti) i cili do të suportoje krijimin e raporteve template të cilat do jenë të konfigurueshme nga vetë përdoruesi
- Të ofrojë mundësinë e ekzekutimit të query-ve të ndryshme në databazë të cilat kanë vetëm akses leximi/selektimi (readonly).
- Automatizim raportesh – duke skeduluar kohën e gjenerimit të tyre
- Të suportoje një mënyrë standarte, konsistente dhe të integruar të të dhënave
- Të ofrojë mjete për ekstraktimin, konvertimin dhe ngarkimin e të dhënave

Organizimi funksional i ndërfaqjes mbi raportimin e të dhënave të sistemit DAMAS

Kjo ndërfaqje kërkohet të organizohet në nivelet funksionale të paraqitura si më poshtë, po pa u limituar në ato:

- Gjenerimi i raporteve të paracaktuara
- Ndërfaqe për krijim template raportesh
- Gjenerimi i raporteve të cilat mund të konfigurueshme sipas filtrave të ndryshëm.

Ky funksion duhet të suportojë krijimin e raporteve të paracaktuara të cilat paraqesin të dhënat bazike nga çdo modul funksional i sistemit. Raportet e gjeneruara nga ky funksion duhet të përfshijnë të dhënat e mëposhtme:

- Të dhëna të procesit të ankandit
- Të dhëna të kontratave bilaterale
- Të dhëna të subjektit tregtues
- Të dhëna të procesit të skedulimit
- Të dhëna të procesit të balancimit
- Të dhëna të procesit të llogaritjes(settlementit) dhe faturimit
- Të dhëna të bllokut të interkonektorëve

Të gjitha këto raporte duhet të jenë të ekstraktueshme në dy formate:

- CSV(excel)
- PDF

Përdoruesit i duhet dhënë mundësia e gjenerimit të këtyre raporteve sipas rezolucionit kohor të dëshiruar dhe duke aplikuar filtra të ndryshëm të cilët mund të bazohen në selektimin e kufirit apo kategorisë së raportit.

Tool për krijim template raportesh

Ndërfaqja duhet të japi mundësinë që më anë të një mjeti (tool) të krijohen raporte të cilat janë të konfigurueshme sipas nevojës së përdoruesit.

Ndërfaqja duhet të japi mundësinë e konfigurimit dhe gjenerimit të disa raporteve template. Ky master raport do të jetë i konfigurueshëm duke i dhënë përdoruesit të drejtën e aplikimit të filtrave dhe opsioneve të ndryshme konfigurimi. Në këtë mënyrë përdoruesi mund të gjenerojë raporte në bazë të nevojave të tij. Këto raporte template do të konfigurohen duke përcaktuar vetë përdoruesi kolonat të cilat përfaqësojnë të dhëna nga module të ndryshme. Më pas ku raport do të popullohet me të dhëna të cilat do të thirren nga useri me anë të query-ve të ndryshme. Sasia e të dhënave që do popullojë një raport template do të varet nga aplikimi i kushteve të ndryshme, siç mund të jetë kushti kohor.

Përdoruesit do ti ofrohet mundësia e aksesimit të databazës së sistemit duke aplikuar query (komanda mbi bazën e të dhënave) të ndryshme të cilat kanë vetëm akses leximi mbi të dhënat. Pra me anë të këtyre komandave (query) useri nuk do të modifikojë, editojë apo fshij të dhëna. Komandat e aplikuara mbi databazën do të jenë të tipit: Select
Gjithashtu duhet të ofrohet selektimi nga disa tabela të cilat kanë lidhje me njëra tjetrën dhe të grupohen këto të dhëna sipas kushteve kohore apo vetisë(kolonës) së preferuar nga përdoruesi. Karakteristikat bazë të një raporti template do jënë si më poshtë:

- *Vetia/Karakteristika Tipi*
- *ID_Template Report AI(Auto Increment) Primary Key*
- *Report Name Text*
- *Description Text*
- *Time Date &Time*

Veprimet e lejuara mbi këto raporte:

- Konfigurim dhe gjenerim
- Editim
- Fshirje
- Ruajta
- Skedulim i raporteve – mund të automatizohet gjenerimi i këtyre raporteve duke skeduluar Kohën e gjenerimit të tyre. Pra të përcaktohet ora kur do gjenerohen dhe periudha e ekzekutimit të këtij tasku.

2.2.3 Sinkronizimi i Platformës Production me atë Test

Sistemi DAMAS, siç mund të identifikohen qartë në skemën e organizimit të këtij sistemi në paragrafin 2.1.1 (Hardëare i Platformës DAMAS) është i përbërë nga dy mjedise të veçanta operimi:

- Mjedisi operimit TEST
- Mjedisi i operimit PRODUCTION

Cdo ndryshim/zgjerim pjesëmarrësish të platformës DAMAS, çdo shtim funksionaliteti të ri apo modifikim i një funksionaliteti ekzistues së pari duhet të implementohet në mjedisin test. Pas testimit të suksesshëm në këtë mjedis, administratorët e DAMAS kryejnë të gjitha konfigurimet në mjedisin Production. Nisur nga roli i mjedisit Test, nuk mund të kemi asnjë përdorues/pjesëmarrës tregu apo funksion më tepër në mjedisin Production se në atë test. Për të patur një kontroll më të mirë të veprimeve që kryhen në mjediset e operimit të sistemit DAMAS (Test dhe Production), nëpërmejt këtij projekti kërkohet:

- Sinkronizimi i të gjithë të dhënave të sistemit Production me atë Test. Nga verifikimet e kryera rezulton që në sistemin Production ka më tepër rekorde në rregjista se në atë Test. Ky mossinkronizim pengon zhvillimin e testeve të nevojshme për një ndryshim të ri në funksion/pjesëmarrës tregu.

- Kontrolli automatik mbi sinkronizimin e dy mjediseve (Test dhe Production) në mënyrë periodike (çdo një muaj) dhe gjenerimi i një raporti ku të identifikohen të gjitha ndryshimet mes dy mjediseve. Ky raport do të shqyrtohet nga grupi i administrimit të sistemit DAMAS dhe do të merren masat e nevojshme.

2.2.4 Organizimi i Modulit të Balancimit konform me rregullat

Moduli i Tregut Balancues mbështet blerjen e Energjisë Balancuese në Tregun Balancues (BM) nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), në mënyrë që të sigurojë fleksibilitetin dhe stabilitetin e Sistemit Kombëtar të Energjisë dhe të japë zgjidhje komerciale për kufizimet e Rrjetit. Moduli i Balancimit duhet të organizohet në mënyrë të tillë që të mundësojë automatizimin e plotë të shërbimeve balancuese sipas rregullave bashkëngjitur këtij dokumenti specifikimesh, si dhe të kryej intergimin e këtij moduli me istemin SCADA të OST sh.a. Lidhur me këtë, Bazuar në rregullat e Tregut Balancues Kontraktori duhet të hartojë një projekt teknik të detajuar mbi implementimet e nevojshme. Projekti teknik në fjalë duhet të aprovohet nga OST sh.a. Më poshtë paraqitet një pershkrim i Tregut balancues si dhe të dhënat për tu integruar me sistemin SCADA.

• Pershkrim i Tregut Balancues

Në Tregun Balancues tregtohet Energjia Balancuese në lidhje me:

- a) Rregullim sekondar.
- b) Rregullimin e Shpejtë Terciar.
- c) Rregullimin e ngadaltë Terciar.


Tregu Balancues ka si blerës vetëm OST dhe Palët e licencuara që operojnë si njësi dispeçeruese dhe / ose kanë ngarkesa dispeçeruese janë të detyruar (pasi të licencohen) të bëhen pjesmarrës të Tregut Balancues.

Proceset e Biznesit

Moduli i Tregut Balancues zgjidh këto procese:

- Përpunimi i ofertave duke siguruar paraqitjen e ofertave, vlerësimin dhe verifikimin përfundimtar
- Përmbyllja e transaksioneve si:
 - Vlerësimi i ofertave dhe i nevojave për energjinë balancuese duke gjetur një optimale ekonomike,
 - Përpunimi i transaksioneve dhe urdhrave Dispeçer,
 - Përlllogaritjet paraprake të energjisë Balancuese të përdorur për transaksionet e konfirmuara.

Figurat e mëposhtme tregojnë rrjedhën e proceseve të Modulit të Tregut Balancues



1.1 Proçesi i Nominimit të Energjisë

1.1.1 Proçesi i nominimit

2.1.1.1 Furnizuesi: PPB-të

- a. Informacioni hyrës: tregtimet ndër-kufitare, p.sh për çdo PShD të ditës së transaksionit
 - i. PPB nominuese;
 - ii. Numri i kontratës së të drejtave të kapacitetit ndër-kufitar të alokuar;
 - iii. Zona e ofertimit fqinje;
 - iv. PPB e nominuar (d.m.th PPB e huaj, duhet të njihet si PPB nga OST fqinje);
 - v. Vëllimi i të drejtave të kapacitetit të nominuar për transaksionin respektiv;

- vi. Drejtimi i nominimit
 - b. Tregtimet brenda-vendit, p.sh për secilën PShD të tregimit në ditën e transaksionit
 - i. PPB nominuese (çdo PPB me njohje tregtare ose të plotë);
 - ii. PPB e nominuar (çdo PPB me njohje tregtare ose të plotë);
 - iii. Energjia e transferuar;
 - iv. Drejtimi i transferimit të energjisë;
 - c. Shkëmbimet brenda-vendit të rrjetit
 - i. PPB nominuese (vetëm me njohje të plotë)
 - ii. Dita e nominimit
 - iii. Për çdo Pikë Lidhje dhe PShD
 - iii.1 PShD
 - iii.2 Kodi EIC i pikës së lidhjes
 - iii.3 Vëllimi i nominuar i shkëmbimit në rrjet
 - iv.1 Drejtimi i vëllimit të nominuar të shkëmbimit në rrjet
- 2.1.1.2 Proçesi: (shënim: të gjitha kohët janë me orën lokale në Shqipëri)
- a. PPB-të që zotërojnë të drejtat afatgjata të transmetimit, paraqesin transaksionet që ato dëshirojnë të bëjnë duke përdorur këto të drejta jo më vonë se ora 9.00 para ditës së transaksioneve. Kjo do të bëhet përmes një mesazhi elektronik standart.
 - b. Në rast se një PPB humbet një afat për nominimin afatgjatë të kapacitetit, OST nuk do të pranojë asnjë nominim ndër-kufitar që përdor këto të drejta kapaciteti.
 - c. OST informon tregun për nominimet e pranura ndërkufitare të të drejtave afatgjata të kapaciteteve të alokuara dhe kapacitetin ndërkufitar të mbetur në dispozicion për tregun e përbashkët të ditës në avancë jo më vonë se ora **xxh:00** (Për t'u plotësuar nga OST, zakonisht të paktën 1 orë para hapjes së portës së tregut të ditës në avancë)
 - d. Të gjitha nominimet afatgjata dhe të ditës në avancë si dhe të gjitha nominimet brenda-vendit që rezultojnë nga tregu i ditës në avancë do të paraqiten para orës 14:00 të ditës para ditës së transaksionit.
 - e. Kërkesat e miratimit të nominimeve të energjisë nga një PPB:
 - i. OST mund të refuzojë miratimin e një nominimi nëse nuk ka konsistence të brendshme ose të jashtme.

- i.1. Konsistenca e brendëshme nënkupton:
 - i.1.1. Për një PPB me njohje të plotë:

Për çdo PShD, tërheqjet e nominuara të rrjetit plus shitjet e nominuara të PPB-të e tjera, plus eksportet e nominuara janë të barabarta me injektimet e nominuara të rrjetit, plus blerjet e nominuara nga PPB-të e tjera plus importet e nominuara.
 - i.1.2. Për një PPB me njohje tregtare:

Për çdo PShD, shitjet e nominuara të PPB-të e tjera plus eksportet e nominuara janë të barabarta me blerjet e nominuara nga PPB-të e tjera plus importet e nominuara
 - i.2. Konsistenca e jashtme nënkupton që:

Të gjitha informacionet mbi një transaksion janë në konsistencë me çdo informacion mbi të njëjtin transaksion nga PPB-të e tjera respektive.

Për transaksionin ndër-kufitar kjo nënkupton se OST do të kontrollojë konsistencën e jashtme me OST fqinje respektive: PPB-të në të dy anët duhet të kenë nominuar të njëjtën sasi, por në drejtim të kundërt.

Në rast të konflikteve në konsistencat e jashtme të transaksioneve ndërmjet dy PPB-ve, do të zbatohet vëllimi më i vogël i nominuar i tregtimit dhe PPB-të do të informohen sipas rastit.

Në rast të mos konsistencës së jashtme në lidhje me transaksionet me PPB e PX , nominimet e PX do të prevalojnë. PPB-të respektive do të informohen sipas rastit në mënyrë që të mund të përshtatin nominimet e tyre të shkëmbimit në rrjet për të qenë në balancë me nominimet e rregulluara tregtare (nëse nevojitet).
 - ii. Në rast të mosmiratimit, OST informon PPB-të respektive, të cilat më pas paraqesin nominime të përmirësuara sa më shpejt që të jetë e mundur. Këto nominime kërkojnë përsëri miratimin nga OST.
- f. Nominimet e miratuara hyjnë në fuqi në orën 00:00 të ditës respektive.
- g. Ndryshimet në nominime:
- i. Ndryshimet mund të paraqiten deri në orën 10:00 pas ditës së transaksionit (D+1, 10:00)
 - ii. Në rast të ndryshimeve, i gjithë nominimi për ditën në fjalë duhet të ri-dërgohet. Nëse miratohet, nominimi i ri zëvendëson atë të vjetrin. Nominimi i ri nuk mund të miratohet pjesërisht.
 - iii. Ndryshimet duhet të miratohen nga OST nëse: (shënim: kjo do të thotë se në të kundërt ato mund të refuzohen):
 - iii.1. Kanë të bëjnë me transaksionet brenda-vendit dhe ndryshimet e paraqitura nga të gjitha PPB-të respektive janë konsistente
 - iii.2. Kanë të bëjnë me transaksionet ndër-kufitare dhe ndryshimet e paraqitura konfirmohen nga OST në anën tjetër të kufirit ose nga platforma përkatëse e kapaciteteve që vepron në emër të atij OST dhe ndryshimet paraqiten jo më vonë se një orë para orës së transaksionit.

2.1.1.3 Rezultati:

- a. Nominimet ndër-kufitare dhe brenda-vendit të miratuara të të gjitha PPB-ve
- b. Pozicioni neto i nominuar për çdo PShD për secilën PPB (për qëllime të shlyerjes së disbalancës), shuma e miratuar
 - i. — Nominimet e tërheqjeve të rrjetit në çdo pikë lidhje të PPB
 - ii. + Nominimet e injektiveve të rrjetit në çdo pikë lidhje të PPB
 - iii. — Nominimet ndër-kufitare të eksportit në të gjitha kufijtë e zonës
 - iv. + Nominimet brenda-vendit të importit në të gjitha kufijtë e zonës

2.1.1.4 Klientët:

- a. PPB-të

1.1.2 Mbylljet e portës së nominimit

2.1.2.1 09:00 D-1: Nominimet ndër-kufitare të të drejtave afatgjata të kapacitetit

2.1.2.2 14:00 D-1: Nominimet brenda-vendit dhe ndërkufitare

2.1.2.3 H-1: Ndryshimet në nominimet ndër-kufitare (p.sh. brenda ditës)

2.1.2.4 D + 1, 10:00: Nominimet brenda-vendit

1.1.3 Proçesi i komunikimit - palët dhe mesazhet

2.1.3.1 Palët janë PPB-të dhe OST.

2.1.3.2 Nga përshkrimi paraprak, mesazhet e komunikimit të kërkuara mund të rrjedhin dhe të hartohen në një diagramë veprimesh të proçesit të aktivitetit si një ndihmë për analizën e papajtueshmërisë me sistemin DAMAS që do të kryhet nga OST. Nga OST gjithashtu do të hartohet, nëse është e nevojshme diagrama e veprimeve të proçesit të aktivitetit,

2.1.3.3 Lista jo-shteruese e mesazheve përbëhet nga:

- a. Mesazhi fillestar i paraqitjes së nominimit
- b. Mesazhi i ri-paraqitjes së nominimit (p.sh. pas refuzimit ose gabimit në komunikim)
- c. Mesazhi i ndryshimit të nominimit
- d. Mesazhi i miratimit të nominimit
- e. Mesazhi i refuzimit të nominimit

1.1.4 Nominimet ex-ante

2.1.4.1 Nominimet fillestare për transaksionet ndër-kufitare që përdorin të drejtat afatgjata të kapaciteteve të alokuara si dhe nominimet për transaksionet brenda-vendit dhe transaksionet ndër-kufitare që vijnë nga tregu i ditës në avancë (i përbashkët) duhet të paraqiten në D-1 para orës 14:00.

2.1.4.2 Nominimet shtesë përshkruhen si ndryshim në nominimet e mësipërme. Nominimet shtesë për transaksionet ndër-kufitare mund të paraqiten deri në një orë para orës së transaksionit.

1.1.5 Nominimet ex-post


2.1.5.1 Vetëm nominimet brenda-vendit do të pranohen *ex-post*. Ora përfundimtare e mbylljes së portës për nominimet brenda-vendit është D + 1, 10:00.

1.1.6 Fall-back

2.1.6.1 Në rast se sistemi i mesazheve elektronike nuk funksionon ose PPB nuk ka përkohësisht akses në sistem, një procedurë emergjence mund të lejojë PPB-të të dorëzojnë nominimet / ri-nominimet nëpërmjet e-mailit , sipas kërkesave të një formati të përcaktuar nga OST.

➤ PROCESI I ANGAZHIMIT MBI DISPONUESHMËRINË DHE LEVRIMIN

OST është përgjegjës për prokurimin e kapacitetit balancues në ankandet e angazhimit për disponueshmërinë dhe të mundësisë për aktivizimin e levrimit së energjisë balancuese në ankandin e angazhimit për lëvrim.



Angazhimi i burimeve për të mbajtur frekuencën e rrjetit në nivelin e pranueshëm, organizohet nëpërmjet katër produkteve balancuese të paraqitura në këtë seksion. OshB (ofruesi i shërbimit të balancimit) është operatori i njësive teknike që ofron cilindo nga këto tre shërbime për rregullimin e frekuencës. Një përmbledhje e shkurtër e informacionit kryesor të rëndësishëm në lidhje me secilin nga produktet paraqitet në tabelën më poshtë:

Produkti	Dimensi onimi	Vëllimi i kërkuar (indikativ)	Kapaciteti i kontraktuar me bazë	Periudha e kontraktimit	Çmimi i kapacitetit	Çmimi i energjisë balancuese
FCR	Po	...	Vjetore	1 vit	<i>Sipas ofertës</i>	ska, energjia e ofruar do të shlyhet si disbalancë
aFRR	Po		Javore	1 javë	<i>Sipas ofertës</i>	<i>Paguar me çmimin më të ulët të ofruar (aFRR+mFRR)</i>
mFRR	Po		Javore	1 javë	<i>Sipas ofertës</i>	<i>Paguar me çmimin më të ulët të ofruar (aFRR+mFRR)</i>
Rezerv a e emergj encës	Jo		Vjetore	1 vit	<i>Sipas ofertës</i>	<i>Sipas ofertës</i>

➤ PROCESI I AKTIVIZIMIT

FCR

FCR aktivizohet vazhdimisht duke reaguar ndaj devijimeve të vrojtuar të frekuencës së matur me frekuencën nominale. Niveli standard i frekuencës është 50Hz, por frekuenca mundet të devijojë pak nga kjo vlerë për të korrigjuar devijimet e agreguara të frekuencës gjatë kohës (e ashtquajtura frequency time deviation). OST duhet të informojë OShB-të ofrues të FCR-së për çdo ndryshim kontribut të tyre në FCR në mënyrë që ata të mund të tarojnë kontrollorët e tyre primarë, sipas rastit.

Pas reagimit fillestar, i cili është një veprim i përbashkët i të gjithë ofrueseve të FCR-së në të gjithë sistemin sinkron, frekuenca duhet të kthehet në vlerën nominale.

aFRR

Si një hap tjetër në kontrollin e frekuencës, blloku i kontrollit LFC që shkakton devijimin e frekuencës duhet të rivendosë pozicionin e tij neto (= shuma e flukseve në import minus flukset në eksport, të korrigjuara për rregullimin primar) në pozicionin neto të skeduar (= shuma importeve të skeduar minus shumën e eksporteve të skeduar). Balancimi ndërmjet këtyre dy vlerave është balanca e sistemit. Kjo balancë duhet të rivendoset brenda TTRF (Koha për Rivendosjen e Frekuencës) e cila në sistemin sinkron të Evropës Kontinentale është

përcaktuar 15 minuta. Kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet një procesi të koordinuar dhe centralizuar nga OST: me anë të aktivizimit automatik të aFRR nëpërmjet sistemit LFC në kombinim me aktivizimin manual të mFRR me anë të mesazheve elektronike (set point).

OST do të përpiqet të minimizojë kostot totale të aktivizimit të rezervave, për të rivendosur balancën e sistemit. Prandaj duhet të marrë vendimet e mëposhtme:

- a. Sa nga ofertat e ofruara për FRR do të përdoren për aktivizimin automatik të LFC?
- b. Në çfarë kushtesh duhet rritur aFRR në LFC ose kur duhet aktivizuar mFRR në vend të saj?

Procedura konkrete përcaktohet si më poshtë:

- a. **Procesi i nominimit**, duke dhënë për përzgjedhje dhe aktivizim ofertat e aFRR të vendosura si më të lira, të paktën deri në vëllimin e kërkuar të LFC. Ky nominim bëhet për çdo PShD (periudhe shlyerje disbalancash) menjëherë pas mbylljes së portës për ofertim. OShB-të e përfshira informohen se ofertat e tyre janë nominuar për rregullimin LFC. Në rast se do të përzgjidhen dhe aktivizohen të gjitha ofertat e nominuara/pranuara, dhe pritet që disbalanca do të vazhdojë, ka dy mundësi nga të cilat operatori duhet të zgjedhë më optimalen, duke marrë parasysh vëllimin e aktivizuar, kohëzgjatjen e pritshme të disbalancës, cilësinë e kërkuar të kontrollit të balancës dhe kostot respektive:
 - i. Nominohen dhe shtohen në LFC më shumë oferta për aFRR ; ose
 - ii. Aktivizohen ofertat e mFRR (me çmim oferte sipas *rendit të meritës*) me qëllim që të zëvendësohet aFRR e aktivizuar

Parimisht, nëse ofertat e mFRR janë më të lira dhe ekziston mundësia që kjo disbalancë të vazhdojë për PShD aktuale dhe atë në vijim, mundësia (ii) do të preferohet krahasuar me mundësinë (i),

- b. **Procesi i përzgjedhjes**, ky është një algoritëm automatik brenda LFC që përzgjedh nga ofertat e nominuara, aq oferta sa nevojiten me çmimin sipas *rendit të meritës* për t'u aktivizuar në paralel me qëllim që të arrihet përgjigja e kërkuar. Ky proces operon në dy drejtime: përzgjidhen më shumë oferta nëse nevojitet më shumë reagim, përzgjidhen më pak oferta nëse nevojitet më pak reagim.
- c. **Procesi i aktivizimit**:
 - i. Të gjitha ofertat e përzgjedhura aktivizohen paralelisht (pro-rata);

- ii. Ofertat që aktivizohen nga LFC në një PShD, por nuk janë më të disponueshme ose janë përzgjedhur për PShD pasardhëse, vendosen në zero duke respektuar shpejtësinë e rregullimit që ishte specifikuar. Megjithëse kjo krijon energji balancuese të aktivizuar për atë ofertë në PShD-në pasuese, oferta të tilla nuk do të ndikojnë në çmimin e aktivizimit në PShD-në pasardhëse.
- iii. Kërkesa për sasinë e energjisë së aFRR monitorohet vazhdimisht nga LFC kombëtare për çdo cikël të LFC dhe ky informacion regjistrohet për çdo ofertë dhe për çdo 5 min për qëllime të shlyerjes. Çdo OShB (ose PPB-ja e tij) gjithashtu pritët të regjistrojë energjinë e aktivizuar nga OST me qëllim lehtësimin e kontrollit në informacionin e shkëmbyer.

Një sasi standarde e aFRR së ofruar nominohet me Cmim sipas *rendit të meritës*, të barabartë me kërkesat e dimensionimit, për secilën PShD. Kjo është e mjaftueshme për të rregulluar gabimet në disbalancë.

Përveç kësaj, mund të nominohen gjithashtu ofertat për aFRR deri në 100% të vëllimit kërkesës së dimensionyuar për mFRR, deri sa ofertat e nominuara të aFRR bëhen më të shtrenjta se oferta më e lirë e mFRR.

Kriteri i përzgjedhjes për përzgjedhjen e ofertave nga LFC është shpejtësia e disponueshme (ramp) e rregullimit nga ofertat e përzgjedhura kundrejt shpejtësisë së kërkuar të rregullimit siç kërkohet nga LFC. Nëse kjo është më e lartë, ofertat përzgjidhen në drejtim të kundërt sipas *rendit të meritës* së çmimit. Nëse kjo është më e ulët, ofertat përzgjidhen sipas *rendit të meritës* së çmimit.

Kur gjatë një periudhe të caktuar kohore janë aktivizuar ofertat në LFC që janë më të shtrenjta se oferta tjetër e disponueshme në rangun e ofertës së mFRR, nëse operatori i sistemit gjykon që rreziku i mbi-aktivizimit është minimal, aktivizohet oferta e mFRR.

Shihni specifikimet e **procesit të nominimit** në Specifikimin e Rregullave Operative.

mFRR/RR me kohë aktivizimi ≤ 30 min.

Ofertat e mFRR përdoren për disbalanca të mëdha dhe/ose që pritët të zgjatin në kohë. Fillimisht OST zbulon humbjen në shkallë të gjerë të prodhimit ose ngarkesës nga gradienti i rritjes së disbalancës e krahasueshme me madhësinë e ndërprerjes. OST gjithashtu mund të marrë informacion nga pjesëmarrësi përkatës tregut mbi një vlerësim të shkallës në të cilën dhe kohën në të cilën, pasojat e ndërprejes priten të eliminohen nga vete pjesëmarrësi i tregut. Paralelisht, disbalanca do të zvogelohet automatikisht nga LFC me anë të aFRR në dispozicion. Nëse aFRR-ja e mbetur në dispozicion bie poshtë një pragu të caktuar dhe pritshmëria është që incidenti të vazhdojë me gjatë se sa disa PShD, atëherë mFRR do të aktivizohet manualisht nga OST derisa aFRR e mjaftueshme të vihet në dispozicion për shkak të veprimeve korrigjuese të pjesëmarrësve të tregut. Gjithashtu çmimi i aktivizimit mund të

jetë një arsye për të aktivizuar mFRR kur është më i lirë se sa aktivizimi i aFRR më gjatë. Ofertat e mFRR aktivizohen për një periudhë minimale të një PShD të plotë dhe gjithmonë në madhësinë e plotë të ofertës.

Rezervat e Emergjencës

Në rast të rezervave të emergjencës së kontraktuara, ato do të aktivizohen vetëm pas paraqitjes së një mesazhi urgjent të tregut se ekziston një rrezik në rritje i aktivizimit të rezervave të emergjencës, përveç rasteve kur sigurohen më shumë oferta të mFRR në rritje. Ky mesazh mundet tashmë të transmetohet në ditën paraardhëse, pas mbylljes së portës të ditës paraardhëse për ofertimin e rezervave nëse ofertat e aFRR dhe mFRR në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar kërkesat e dimensionimit.

Rezerva Zëvendësuese me kohë aktivizimi > 30 min.

Çdo ofertë për rezerva të aktivizuara manualisht me kohë aktivizimi më të madhe se 30 minuta do të kategorizohet si "oferta për qëllime të tjera". OST do të aktivizojë keto oferta vetëm për rastet e kongestionit dhe menaxhimit të sigurisë të rrjetit.

Nëse këto oferta janë aktivizuar, ata do të marrin për kompensimin e kostove të aktivizimit, çmimin më të lartë të ofertës dhe çmimin e energjisë balancuese, por nuk duhet të vendosin çmimin e energjisë balancuese. Kështu ata do të cilësohen si të aktivizuara për qëllime të tjera. Çdo ofertë e aktivizuar në drejtim të kundërt për të mbajtur balancën nuk do të cilësohet dhe mund të shlyhet si çdo ofertë tjetër balancuese (*paguar me çmimin më të ulët të ofruar*).

➤ Kategoritë e ofertës

Të gjitha ofertat e angazhimit për levrim për aFRR, mFRR dhe RR i përkasin :

a. Qëllimeve të balancimit:

- i. Ofertat e aFRR të kontraktuara;
- ii. Ofertat e aFRR të pa kontraktuara;
- iii. Ofertat e mFRR/RR.

b. Qëllimeve të tjera (p.sh. menaxhimi i konxhestionit):

- i. Ofertat RR.

➤ Struktura e një mesazhi të ofertës së angazhimit për levrim

Një PPB (pale pergjegjese balancuese) që oferton në emër të një OshB (ofrues i shërbimit të balancimit), mund të dërgojë më shumë se një ofertë angazhimi për levrim në një mesazh të vetëm të ofertës. Mesazhi i ofertës ka tri pjesë:

- Mesazhi i ofertës
- Oferta (0..n për çdo mesazh oferte)
- Rreshtat e ofertës (92..100 për çdo ofertë)

Mesazhi i ofertës përbëhet nga një numër i pakufizuar i ofertave. Një mesazh oferte me numrin e ofertave zero (0) tregon se PPB nuk dëshiron të paraqesë ndonjë ofertë të angazhimit për levrim.

Çdo mesazh i ri i ofertës anulon të gjitha mesazhet e ofertës së mëparshme.

Mesazhet e ofertës shkëmbehen në një format të standartizuar. OST do të përcaktojë dhe ta vendosë këtë format në dispozicion për të gjitha palët dhe njëkohësisht do të publikojë një përshkrim të hollësishëm të këtij formati.

Mesazhi i ofertës dërgohet nga PPB në sistemin qendror të mesazheve të OST, dhe do t'i drejtohet personit të kontaktit të përcaktuar nga OST.

Çdo ofertë e angazhimit për shpërndarje për aFRR/mFRR/RR përbëhet nga rreshtat e ofertës, një për çdo PShD (periudha e shlyerjes së disbalancave) (çdo 15 minuta). Çdo ditë kalendarike numëron 96 PShD (periudha e shlyerjes së disbalancave)

➤ Karakteristikat e një mesazhi oferte

Karakteristikat e një mesazhi oferte paraqiten në tabelën në vijim:

Karakteristika	Njësia	Përshkrimi	Vlerat e lejuara
OShB	N/A	Identifikimi i OShB	Kodi EIC
PPB	N/A	Identifikimi i PPB, disbalanca e të cilit do të rregullohet në aktivizim	Kodi EIC
Kërkesa	N/A	Nëse mesazhi është paraqitur me kërkesë të OST, duhet të përfshihet numri i kërkesës së OST	Numri i kërkesës së OST
Data e shpërndarjes	N/A	Data për të cilën janë të vlefshme ofertat	Diapazoni i datave: Aktuale ne Aktuale + 7 ditë kalendarike

➤ Karakteristikat e një oferte të angazhimit për levrim

Karakteristikat e një oferte të angazhimit për shpërndarje paraqiten në tabelën në vijim:

Karakteristika	Njësia	Përshkrimi	Vlerat e lejuara
Marrëveshja	N/A	Identifikimi i marrëveshjes midis OShB dhe OST	Numri i kontratës me OST përmban 10 karaktere alfa-numerike
Referenca	N/A	Identifikimi unik i ofertuesit të ofertës si pjesë e mesazhit	zgjedhja e ofertuesit
Objekti ³	N/A	Një objekt i mundëson një ofertuesi të bashkojë dy oferta. Nga një Objekt vetëm një ofertë mund të aktivizohet në të njëjtën kohë.	zgjedhja e ofertuesit
Koha e aktivizimit	PShD (periudha e shlyerjes së disbalancave)	Intervali minimal i PShD në lidhje me PShD aktuale për të cilën ofrohet oferta për t'u aktivizuar nga OST; ndryshon aFRR, mFRR/RR për balancimin, mFRR/RR për qëllime të tjera	Numër i plotë në diapazonin 0 deri 672 (7 ditë) aFRR (e kontraktuar/jo e kontraktuar): Koha e Aktivizimit = 0; mFRR për balancim: Koha e Aktivizimit = 1; RR për balancim: Koha e aktivizimit = 2, 3, 4; RR për qëllime të tjera: Koha e Aktivizimit ≥ 5
			Numër i plotë 1 ose në diapazonin 0 deri 672 (7 ditë)

³ Një objekt aFRR bashkon dy oferta të shenjave të kundërta (në rritje/në rënie); Një objekt mFRR/RR për qëllime të tjera bashkon dy oferta me madhësi oferte dhe kohë aktivizimi të ngjashme, por me kohëzgjatje aktivizimi dhe çmim të ndryshëm.

Karakteristika	Njësia	Përshkrimi	Vlerat e lejuara
Kohëzgjatja e aktivizimit	PShD	Numri minimal i PShD-ve të njëpasnjëshme për aktivizimin e pranueshëm nga OST	aFRR (e kontraktuar/jo e kontraktuar), mFRR / RR për balancim: Kohëzgjatja e Aktivizimit = 1; RR për qëllime të tjera: Kohëzgjatja e aktivizimit ≥ 4
Vëllimi	MW	Madhësia e ofertës + në rritje – në rënie	Në rritje: numër i plotë në diapazonin 4 deri 200; Numër i plotë në diapazonin -4 deri -200;
Shkalla e rregullimit ⁴	%/min e madhësisë së ofertës (karakteristika "Vëllimi")	Shkalla e rregullimit, si përqindje e karakteristikës Vëllim për minutë	Numër më një shifër pas presjes dhjetore, në diapazonin 7.0 deri në 100.0
Vendndodhja/ Rrjeti i objektit	N/A	Një lidhje, ose një grup lidhjesh, brenda rrjetit të tensionit të lartë, nga i cili OShB do të dispeçerojë aktivizimin. Kjo lidhje ose grup lidhjesh i përket një pronari ose administratori.	Kodi EIC

➤ Karakteristikat e rreshtit të ofertës së angazhimit për levrim

Çdo PShD në datën e levrimit për të cilën oferta është në dispozicion duhet të specifikohet.

Karakteristika	Njësia	Përshkrimi	Vlerat e lejuara
----------------	--------	------------	------------------

⁴ Shënim: Kjo karakteristikë gjithashtu mund të përcaktohet si koha e plotë e aktivizimit (FAT-full activation time) në minuta, atëherë shkalla e rregullimit mund të rrjedhë nga: shkalla e rritjes = $60 / \text{FAT} [\% / \text{min}]$

Disponueshmëria	PShD (periudha e shlyerjes së disbalancave)	Numri i PShD për të cilat aplikohet oferta	Numër i plotë unik në diapazonin 1 deri në 100, në rritje
Çmimi i ofertës	€/MWh	Çmimi i ofertës së energjisë balancuese	Numër me dy shifra pas presjes dhjetore Vlera në diapazonin -10,000.00 deri në +10,000.00

Për ofertat për qëllime balancimi çmimi i ofertës mund të ndryshojë për çdo PShD; për ofertat për qëllime të tjera çmimi i ofertës duhet të jetë i pandryshueshëm.

Simboli (shenja) i produktit të madhësisë së ofertës dhe çmimit të aktivizimit të energjisë balancuese të OShB tregon drejtimin e fluksit të parasë, me + tregon se OST paguan OShB dhe - , OShB paguan OST. Nëse Vëllimi = 0, çmimi i ofertës nuk zbatohet.

Simboli (shenja) i ofertës dhe çmimi i aktivizimit që rrjedhin nga çmimet e ofertës për të gjitha ofertat e aktivizuara diktojnë drejtimin e fluksit të parasë:

	Çmimi i aktivizimit >0	Çmimi i aktivizimit <0
Energjia balancuese në rritje	OST paguan OShB	OShB paguan OST
Energjia balancuese në rënie	OShB paguan OST	OST paguan OShB

➤ Mbyllja e portës së ofertimit

✓ Para ditës së levrimit

Ofertat e energjisë balancuese për ditën e levrimit duhet të arrijnë në OST deri në orën 14:00 çdo ditë para ditës së levrimit. Mesazhet e ofertës për aFRR/mFRR/RR të marra nga OST, midis orës 14:00 dhe kohës së miratimit nga OST që nuk janë pajisur me një numër të vlefshëm kërkesë do të injorohen (duke njoftuar dërguesin).

Sapo të ketë kaluar afati i miratimit nga OST, ofertat aFRR/mFRR/RR për ditën e levrimit mund të rishikohen. Proçedura për ditën e levrimit hyn në fuqi në orën 23:00 në ditën e përgatitjes.

✓ **Gjatë ditës së levrimit**

Në ditën e levrimit, afati i fundit për dorëzimin e ofertave të rishikuara të aFRR/mFRR/RR gjithmonë mbyllet një orë para secilës PShD. Pas mbylljes së ofertave për një PShD, të gjitha ofertat për atë PShD refuzohen, përveç atyre që kanë një *Numër Kërkese* të lëshuar nga OST.

Shembull: Është 18:42 dhe një OShB vendos të rishikojë ofertat e tij për ditën aktuale. Në këtë kohë OShB do të lejohet të paraqesë ndryshimet për PShD-në nga ora 19:45 deri në 20:00 dhe për të gjitha PShD në vijim. Në rast se OShB paraqet oferta të ndryshuara për një ose më shumë PShD para orës 19:45, mesazhi i ofertës me të gjitha ofertat e tij do të refuzohet.

✓ **Publikimi i rezultateve**

OST do të publikojë një ofertë të përbashkët sipas *merit order* për qëllime balancimi dhe për qëllime të tjera veç e veç në mënyre anonime. Ky rend i ofertës së përbashkët mund të kërkohej në çdo kohë për ditën tjetër dhe për çdo ditë para saj. Kur publikohen, do të paraqitet data dhe ora e kërkesës si dhe dita e levrimit.

Publikimi i një oferte të përbashkët anonime sipas *merit order* ka përparësitë e mëposhtme:

- a. OShB-të mund ta përdorin atë për të (ri) pozicionuar ofertat e tyre ose për të dhënë oferta të reja.
- b. Në një masë më të vogël, në këtë informacion OShB-të mund të bazojnë vlerësimin e tyre të riskut të disbalancës dhe të veprojnë në tregun brenda ditës sipas rastit. Megjithatë:
 - i. Ofertat nuk janë përfundimtare deri në mbylljen përfundimtare të portës
 - ii. Ka të bëjë me rendin e ofertës së përbashkët të ofertave të aFRR dhe mFRR, ndërsa në praktikë ofertat e aFRR mund të aktivizohen ndonjëherë pas ofertave të mFRR, edhe nëse ato janë më të shtrenjta (për arsye teknike)

Rendi i një oferte të përbashkët anonime sipas *merit order* do të tregonte çmimin e energjisë balancuese në nivele të ndryshme të vëllimeve të aktivizuara, p.sh. në 50 MW, 100 MW, 200 MW, 400 MW dhe 100% të vëllimit total në dispozicion në të dy drejtimet (në rritje dhe në rënie).


✓ **Afatet**

Kjo është një përmbledhje e afateve të përmendura më sipër:

- a. Hapja e portës për ofertimin e angazhimit për shpërndarje: D-7, 0:00
- b. Mbyllja fillestare e portës për ofertimin e angazhimit për shpërndarje për të gjithë PShD-të e ditës D: D-1, 14:00
- c. Miratimi i ofertave fillestare nga OST dhe ri-hapja e portës së ofertave për të gjithë PShD-të e ditës D: D-1, 15:00


- d. Mbyllja përfundimtare e portës për ofertat e angazhimit për shpërndarje të PShD i (i = 0-100) në ditën D: D, 1 orë para fillimit të PShD-së i.

Integrimi midis Moduleve:



Integrimi me sisteme të tjerë

Në kuadër të automatizimit të plotë të modurit të balancimit është e nevojshme të integrohen të dhënat e nevojshme nga sistemi SCADA në sistemin DAMAS si dhe nga sistemi DAMAS në SCADA. Lidhur me këtë, kontraktori duhet të procesojë të dhënat nga sistemi SCADA si dhe të dërgojë drejt këtij të fundit të gjitha të dhënat e nevojshme për të aktivizuar shërbimet balancuese. Lidhur me këtë, është e nevojshme të shkëmbehen të dhënat:



Sistemi Burim	Sistemi i Targetuar	Përshkrimi i rrjedhës së të dhënave	Formati
SCADA	SCADA	DAMFT - Për çdo kufi (UCTE dhe jo-UCTE) Balanca ndërkufitare dhe për çdo njësi të dispeçimit programi fizik i fundit i miratuar	CSV

Moduli I Tregut Balancues	SCADA	Total PN - Programi fizik përfundimtar pas mbylljes së fundit të portës për pranimin e skedulimit të Gjenerimit	CSV
Moduli I Tregut Balancues	SCADA	Pika Base - Ndryshimet e fundit të "Base Point" apo grupeve të rregulluar	CSV
SCADA	Moduli I Tregut Balancues	Energjia Balancuese Sekondare e rezultuar - Realizohet Rregullimi Sekondar i Energjisë për secilën DU.	CSV
SCADA	Moduli I Tregut Balancues	Frekuenca Delta - Frekuenca mesatare për orë e realizuar për DI e ditës më parë.	XML

➤ DAMAS => SCADA

1. ATC –Available Transfer Capacity (per te gjithë kufinjte)
2. Iterchange Schedule
3. Production Schedule per unit
 - a. Base Production Schedule
 - b. aFRR (amount + Merit order)
 - c. mFRR (amount + Merit Order)

➤ SCADA => DAMAS

1. Open Loop ACE
2. Required aFRR
3. Regulation State (+2, +1, 0, -1, -2)
 - no upwards nor downwards regulation requested: regulation state = 0
 - only upwards regulation requested: regulation state = +1
 - only downward regulation requested: regulation state = -1
 - both up- and downward regulation requested but the balance delta has been continuously non-decreasing: regulation state = +1
 - both up- and doënëard regulation requested but the balance delta has been continuously non-increasing: regulation state = -1
 - both up- and doënëard regulation requested but the balance delta has neither been continuously non-increasing nor continuously non-decreasing: regulation state = 2

- both up- and downward regulation requested but the balance delta has been continuously non-increasing and continuously non-decreasing: regulation state = 2
- Komunikimi do të realizohet nëpërmjet FTP dhe web service. Të dhënat do të shkëmbehen në formatin XML. Skema .xsd do të vihet në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor. Prokurimi i rezervës balancuese,
- Identifikimi i disponibilitetit të rezervës në kohë reale nga cdo BSP,
- Identifikimi i aktivizimit të energjisë balancuese në kohë reale (në MW) dhe në intervale 15 min (në MWh),
- Llogaritja e disbalancave të cdo BRP në intervale 15 min (përfshirë vetë BSP-të),
- Settlement-i përkatës (përgatitja e faturës) për cdo BRP dhe BSP, si dhe e pozicionit neto të OST për çdo interval.

➤ Moduli i Menaxhimit të të Dhënave Energjitike:

✓ Llogaritja e çmimit të disbalancës

Çmimet e energjisë balancuese të OShB paguhen si *pay as cleared*. OShB kompesohet me çmimin e tregut (klingut) i cili është i barabartë me çmimin e ofertës më të shtrenjtë të pranuar (në rast të ofertës së kapacitetit) ose të aktivizuar (në rast të ofertës për energji). Si pasojë, llogaritja e çmimit të disbalancës bazohet në çmimet e energjisë balancuese të OShB. Çmimi i disbalancës për mungesat është gjithmone më i lartë ose i barabartë me çmimin më të lartë të energjisë balancuese për aktivizimin në rritje; çmimi i disbalancës për mungesat është gjithmonë më i ulët ose i barabartë me çmimin më të ulët të energjisë balancuese për aktivizimin në rënie (poshtë).

Përkufizime

Rregullimi në rritje

Rregullimi në ulje

Çmimi për energjinë balancuese në rritje

Çmimi për energjinë balancuese në ulje

Komponentja nxitëse

Gjendja e rregullimit(e sistemit)

Delta e balancës: proxy për disbalancat e sistemit për tu publikuar në kohë reale nga OST (open loop ACE)

Mid-Price: përkufizimi i çmimit të energjisë balancuese në rastin pa rregullim

✓ **Specifikimi i gjendjeve të rregullimit (për secilën PShD)**

Gjendja e rregullimit=0 nuk kërkohet as rregullim në rritje dhe as në ulje

Gjendja e rregullimit=+1: kërkohet vetëm rregullim në rritje

Gjendja e rregullimit=-1: kërkohet vetëm rregullim në ulje

Gjendja e rregullimit=+1: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme

Gjendja e rregullimit=-1: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme

Gjendja e rregullimit = 2: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje, por delta e balancës ka qenë as jo-rritëse në mënyrë të vijueshme as jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme.

Gjendja e rregullimit = 2: kërkohet edhe rregullim në rritje edhe rregullim në ulje por delta e balancës ka qenë jo-rritëse në mënyrë të vijueshme dhe jo-zbritëse në mënyrë të vijueshme.

✓ **Specifikimi i çmimeve të disbalancës**

1. Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit =-1 (tepricë në sistem)

- Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në ulje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
- Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepriçë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në ulje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.

2. Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit =+1(sistemi ka mungesë)

- Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në rritje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.

- Nëse disbalanca e PPB ka të beje me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë), çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin e energjisë balancuese në rritje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
3. Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = 2 (disbalance e dyanshme e sistemit)
- Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), dhe mid-price është më i lartë se sa çmimi për energjinë balancuese në rritje, çmimi i disbalancës është i barabartë me mid-price plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
 - Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë) dhe mid-price është më i ulët se sa çmimi për energjinë balancuese në rënie, çmimi i disbalancës është i barabartë me mid-price minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
 - Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë) dhe mid-price nuk është më i lartë se sa çmimi për energjinë balancuese në rritje, çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin për energjinë balancuese në rritje plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
 - Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë) dhe mid-price nuk është më i ulët se sa çmimi për energjinë balancuese në ulje, çmimi i disbalancës është i barabartë me çmimin për energjinë balancuese në ulje minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
4. Çmimi i disbalancës në rast se gjendja e rregullimit = 0 (pa rregullim)
- Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me tërheqjen nga rrjeti (PPB ka mungesë), çmimi i disbalancës është i barabartë me mid-price plus komponenten nxitëse. Në këtë rast PPB paguan OST.
 - Nëse disbalanca e PPB ka të bëjë me injektimin në rrjet (PPB ka tepricë), çmimi i disbalancës është i barabartë me mid-price minus komponenten nxitëse. Në këtë rast OST paguan PPB.
5. Komponentja nxitëse
- Vlera fillestare: €0/MWh, por duhet të jetë e editueshme

- Të krijohet mundësia e agregimit të nominimeve (si furnizues dhe gjenerues) dhe vlerave të matjeve të BRP(Palë përgjegjëse balancues) që kanë pika matje të regjistruara në llogarinë e tyre ndarazi, të cilat angazhohen në një grup balancues, për të mundësuar llogaritjen e disbalancave si grup balancues.
- Të krijohet mundësia e llogaritjes së disbalancës për skedulet e pabalancuara për BRP me njohje tregtare dhe të gjenerohet proforma.

6. Gjenerimi i Proformave: **Settlement of Ancillary Services (SofANS):**

Sistemi gjeneron proforma me bazë mujore për tenderin e prokurimit të humbjeve në rrjet. Tenderat që zhvillon OST janë për periudha të ndryshme ndaj do të ishte më mirë që fatura të gjenerohej për procedurë. Gjithashtu proceset e tenderave për prokurimin e rezervës rregulluese do zhvillohen me bazë javore, në këto kushte sistemi duhet të gjeneroj proforma me bazë javore, por dhe të agreguara.

7. Gjenerimi i Proformave: **BRP Settlement Data Overview:**

Sistemi gjeneron Proforma/Settlement me bazë ditore për çdo Palë Përgjegjëse Balancuese (PPB) por është e nevojshme edhe një Proformë përmbledhëse sipas periudhës të përzgjedhur nga operatori/përdoruesi ku të pasqyrohen të dhënat përkatëse sipas periudhës së përzgjedhur si dhe mundësi për t'u ekstraktuar në format Excel (.xls).

Përkatësisht:

OS		TIRANE, DATE		/ /2019	
INVOICE NR. _____					
bligations of the Company XX for the Imbalances of the period from: DD/MM/YYYY to: DD/MM/YYYY					
Period from:		DD/MM/YYYY	to:	DD/MM/YYYY	
Nr	DESCRIPTION	AMOUNT in [MWh]			
1	Production - MWh	XX			
2	Consumption - MWh	XX			
3	Nomination of Production - MWh	XX			
4	Nomination of Consumption - MWh	XX			
5	Positive Imbalance from Nomination - MWh	XX			
6	Negative Imbalance from Nomination - MWh	XX			
7	Total Imbalance from Nomination - MWh	XX *(Positive-Negative)			
Summary I (Euro)		To be paid by	OST	XX	Euro
Summary II (Euro)		To be paid by	PPB	XX	Euro
Summary I (Lekë)		To be paid by	OST	XX	Lekë*
Summary II (Lekë)		To be paid by	PPB	XX	Lekë*
*according to the Exchange rate of the date of the Settlement					
OST Sh.a.		COMPANY NAME			

Gjenerimi i Proformave: Gjenerimi i proformës duhet të jetë i përditesuar sa herë klikohet, momentalisht është zhvilluar në formë të tillë që nëse klikon një herë në gjenerim ajo mbetet e padryshuar pamvarësisht se mund të jetë gjeneruar vetëm për një fraksion të periudhës.

Si dhe Settlement-i të jetë i aksesueshëm dhe i monitorueshëm edhe nga BRP-ja në kohë reale.

- Të krijohet mundësia e llogaritjeve të disbalancave të çdo BRP-je (Balancing Responsible Parties) si dhe të BSP-ve (Balancing Service Provider) në intervale 15 minutëshe.
- Të krijohet mundësia e lidhjes së afatit kohor me garancin e çdo BRP në momentin kur afati i vendosur nga operatori të ketë mbaruar dhe garancia financiare mos të jetë rinovuar konform akteve rregullatore në fuqi, subjekti si palë përgjegjëse balancuese të mos ketë të drejta si BRP pra të kaloj në status pasiv.

Të krijohet mundësia e gjenerimit të proformës për energjinë e transmetuar nga çdo BRP bazuar në vlerat e matjeve nëse BRP (Palë përgjegjëse balancues) ose BRG (Grup përgjegjëse balancues) ka pika matje të regjistruar në llogarinë e vetë. Të gjenerohet një proformë për sasinë e energjisë së transmetuar për çdo konsumator ose grup konsumatorësh (virtual load) apo sasinë e energjisë së transmetuar të konsumuar për nevojat vetjake të gjeneruesve (virtual load) dhe çmimin (tarifa e transmetimit) i cili të ketë mundësinë e editimit manual.

- Të krijohet mundësia e paraqitjes të Balancës Financiare - pozicionit neto të OST sh.a. (Pozicioni Neto = Arkëtime për OST sh.a. (nga Disbalancat Negative) – Shpenzime nga OST sh.a. (nga Disbalancat Pozitive)) për çdo interval kohe të përzgjedhur nga operatori/përdoruesi.
- Të krijohet mundësia e publikimit të të dhënave në mënyrë automatike në faqen www.ost.al përkatësisht të:
 - Cmimit Mesatar të ponderuar që është aplikuar për Disbalancat sipas periudhës së përzgjedhur nga operatori/përdoruesi.
 - Cmimeve të Disbalancave Pozitive dhe Negative orare (në total për çdo MËh) sipas periudhës së përzgjedhur nga operatori/përdoruesi.

- Volumi total i Disbalancave orare.
 - Balanca Fianaciare mujore e OST sh.a.
- Të krijohet mundësia e përgatitjes së raporteve me vlera si dhe e paraqitjes grafike të tyre sipas informacionit të përzgjedhur nga të dhënat e kërkuara nga operatori/përdoruesi.

2.2.5 Automatizimi i Modulit të Llogaritjes së Energjisë në Kufi

Moduli i “*Llogaritjes Së Energjisë Në Kufi*” është modul funksional dhe në operim në baze ditore. Ky modul është konceptuar konform policës 2 të ENTSO-E si dhe bazuar në marrëveshjet bilaterale me OST-te kufitare. Nëpërmjet procesit të “*Llogaritjes Së Energjisë Në Kufi*” realizohen:

- Sinkronizimi i të dhënave të matjes. OST-te kufitare lexojnë të dhënat nga sistemet e matjes për linjën e interkonjeksionit (në pikat respektive të matjes) dhe shkëmbejnë këto matje mes tyre
- Llogaritja e Energjisë në Kufi bazuar në matjet e shkëmbyera dhe koeficientet e rakorduar në marrëveshjen bilaterale. Në vijim, Energjia e Llogaritur shkëmbehet ndërmjet OST-ve kufitare dhe konfirmohet prej tyre.
- Raporti i konfirmuar i Llogaritjes së Energjisë në Kufi i dërgohet Qendrës Koordinative (në rastin tonë dërgohet në Swissgrid)

Për të realizuar funksionet e mësipërme, moduli i “*Llogaritjes Se Energjisë Në Kufi*” në sistemin DAMAS është i konceptuar sipas blloqeve të mëposhtme:




Secili nga blloqet funksionale të këtij moduli ekzekutohet në orarin e programuar paraprakisht. Oraret janë programuar në bazë të marrëveshjeve bilaterale me secilën OST fqinje. Bazuar nga këto marrëveshje këto orare përfaqesojnë deadline (afatin kohor maksimal për realizimin e secilit funksion). Procesi i “Llogaritjes Së Energjisë Në Kufi” në 90% të rasteve nuk mbyllet në ‘deadline’ por realizohet më parë. Për këtë është e nevojshme që krahas kushtit kohor të ekzekutimit të secilit nga blloqet funksionale të përcaktojmë edhe kushte logjike. Pra, ekzekutimi

i secilit bllok (brenda deadline) do të kryhet sapo të jenë të disponueshme të gjitha të dhënat e nevojshme për ekzekutimin e tij.

Ekzekutimi i një blloku funksional do të kryhet nëse plotësohet kushti kohor OSE nëse plotësohet kushti logjik.

2.2.6 Përmirësimi i “Process Schedules”

“Process Schedules” paraqet të gjithë blloqet funksionale mbi automatizimin e secilit nga proceset që zhvillohen në DAMAS.



Lidhur me këtë, është e nevojshme që për çdo bllok funksional të mund të riekzekutohet me kërkesën nga përdoruesi me rol Administrator. Shumë shpesh pas aktivizimit të ciklit të përputhshmërisë portat mbyllen menjëherë pa ju dhënë kohën e duhur prej 15 minutave PPB-ve të kryejnë nominimet e tyre.

2.2.7 Implementimi i Dashboard mbi kontrollin e proceseve

Nisur nga shumëllojshmëria e proceseve që realizohen në sistemin DAMAS, është e nevojshme të kemi të përmbledhura statuset e zhvillimit të këtyre proceseve. Për këtë është e nevojshme të implementohet “Dashboard” opearacional i strukturuar sipas moduleve funksionale, ku për secilin modul të shfaqet në kohë reale gjëndja e proceseve respektive. Ky organizim i informacionit bazik të proceseve (intenerari i aktiviteteve, koha e ekzekutimit, statusi) ndikojnë në:

- Lehtësim në operimin e sistemit
- Rritja e sigurisë së operimit
- Supervizim dhe audit procesesh

Statusi i secilit nga procesesh duhet të jetë vizualisht i identifikueshëm nëpërmjet ngjyrimit dinamik:

➤ Ne proces

➤ ERROR

➤ Perfunduar me Sukses

Ndërfaqja e Dashboard të proceseve duhet të ofrojnë mundësinë e filtrimit sipas modulit funksional, sipas kufirit (kur është i aplikueshëm), sipas rezolucionit kohor.


2.3 Zhvillimet opsionale në Platformën DAMAS

2.3.1 Konfigurimi i Zonës së Kontrollit të KOSOVES si pjesë e bllokut AL

2.3.2 Konfigurimi i një kufiri të ri energjitik

Ky konfigurim prek procesin e skedulimit , 'accounting' , ankandeve të kapaciteteve dhe alokimit të kapaciteteve në 'Intraday'.

1.Për sa i përket procesit të shkëimit ndërkufitar ,skedulimit, përputhshmërisë:



Procedura organizative midis OST dhe KOSTT në lidhje me procesin e skedulimit duhet të jetë në përputhje me politikën 2 ‘Scheduling and Accounting’ e ENTSO-E RG CE.

TSO janë dakort për formatin elektronik të dokumenteve të shkëmbyera midis tyre për procesin e skedulimit ndërkufitar me dokumentet e përshkruara më poshtë. Në rast të ndonjë problemi në platformat e TSO bihet dakort të përdoren forma të tjera të dokumenteve të cilat dërgohen me mesazhe elektronik.

Të dyja TSO do të përdorin EIC kode të publikuara për identifikimin e pjesëmarrësve dhe BRP-ve në shkëmbimet ndërkufitare.

Në procesin e skedulimit ndërkufitar kanë të drejtë të nominojnë vetëm ata pjesëmarrës të cilët kanë fituar të drejta mbi kapacitetet transmetuese ndërkufitare. Shkëmbimi ndërkufitar duhet të aprovohet nga të dy TSO.

Në këtë proces rëndësi ka caktimi i orareve të mbylljes së portës për skedulimin ndërkufitar për zonat respektive të kontrollit si dhe të procesit 'Cut-Off Time'. Nqs ka një mosdakortësim dëri në momentin e 'Cut-Off Time' atëherë TSO bihen dakort me rregullat e mëposhtme në mënyrë që të kemi një 'CAS' të dakortësuar:

- Kur kemi vlera të ndryshme në një segment kohor të caktuar ,atëherë pranohet vlera më e vogël.
- Kur mungojnë vlerat ,atëherë vlerat merren zero.

- Shkëmbimi i të dhënave elektronike:

- OST
 - damas@mms-ost.al për procesin e skedulimit (shembull)
 - ost.schedule@ost.al për rezervë
 - ost@schedule.ost.al për rezervë
- KOSTT

-Dokumentet e përdorur në procesin e skedulimit:

Në procesin e skedulimit ndërkufitar do të përdoren dokumentet të cilat permban 'Guida për skedulimin dhe proceset e raportimit' version 2.1. Dokumentet e shkëmbyera do të jenë si më poshtë:

- CAS – 'Control area schedule document' – Ky document përmban të gjitha transaksionet tregtare bazuar në kontratat , ndërmjet CA ' Control Area' OST dhe CA KOSTT.
- ACK – 'Acknoëdgement Document' - Dokumenti përmban informacion mbi pranimin ose refuzimin e dokumentit CAS.

Shembull i dokumenteve:

- xml version="1.0" and encoding="UTF-8"
- scheme:
 - XSD equal as
 - XSD
- Emri i dokumentit „xml“ mund te jetë një emër i çfaredoshëm por është e këshillueshme që emri ti referohet përmbajtjes së dokumentit.
- In „Schedule Document“ aplikohet :
 - „Process Type“ A01 in OST'CAS, A17 in KOSTT'CAS: D-1: Dokumenti përfundimtar përmban të gjitha transaksionet bashkë me ato të procesit 'Intraday'.
 - „Business type“ A06: nominimet në kufi pa CAI
 - „Object aggregation“ A03: Pala në Cross-Border .

Shëmbull i CAS për OST:

```
<?xml version="1.0" encoding="utf-8"?>
<ScheduleMessage DtdVersion="3" DtdRelease="3">
  <MessageIdentification v="20171220_CAS_KS_AL" />
  <MessageVersion v="1" />
  <MessageType v="A04" />
  <ProcessType v="A17" />
  <ScheduleClassificationType v="A01" />
  <SenderIdentification v="-----" codingScheme="A01" />
  <SenderRole v="A04" />
  <ReceiverIdentification v="10XAL-KESH-----J" codingScheme="A01" />
  <ReceiverRole v="A04" />
  <MessageDateTime v="2014-11-30T13:29:38Z" />
  <ScheduleTimeInterval v="2014-11-30T23:00Z/2014-12-01T23:00Z" />
  <ScheduleTimeSeries>
    <SendersTimeSeriesIdentification v="O_10007_10100_10008_19928" />
    <SendersTimeSeriesVersion v="1" />
    <BusinessType v="A06" />
    <Product v="8716867000016" />
    <ObjectAggregation v="A03" />
    <InArea v="10YAL-KESH-----5" codingScheme="A01" />
    <OutArea v="-----" codingScheme="A01" />
    <InParty v="12XEFT-SËITZERLR" codingScheme="A01" />
    <OutParty v="34X-00000000008-D" codingScheme="A01" />
    <MeasurementUnit v="MAË" />
    <Period>
      <TimeInterval v="2014-11-30T23:00Z/2014-12-01T23:00Z" />
      <Resolution v="PT15M" />      <Interval>
        <Pos v="1"/>
        <Qty v="15.0"/>
      </Interval>
    </Period>
    <Interval>
      <Pos v="2"/>
      <Qty v="15.0"/>
    </Interval>
    ....
    <Interval>
      <Pos v="96"/>
      <Qty v="15.0"/>
    </Interval>
  </ScheduleTimeSeries>
</ScheduleMessage>
```

Shëmbull i CAS për KOSTT:

```
<?xml version="1.0" encoding="UTF-8"?>
<ScheduleMessage xmlns:xsi="http://ëëë.ë3.org/2001/XMLSchema-instance"
xsi:noNamespaceSchemaLocation="../schedulev2r3/schema/schedule-xml.xsd"
<MessageIdentification v=" 20161219_CAS_AL_KS "/>
<MessageVersion v="1"/>
<MessageType v="A04"/>
<ProcessType v="A01"/>
<ScheduleClassificationType v="A01"/>
<SenderIdentification v="10XAL-KESH-----J" codingScheme="A01"/>
<SenderRole v="A04"/>
<ReceiverIdentification v="----- " codingScheme="A01"/>
<ReceiverRole v="A04"/>
<MessageDateTime v="2008-11-18T12:04:41Z"/>
<ScheduleTimeInterval v="2008-11-18T23:00Z/2008-11-19T23:00Z"/>
<ScheduleTimeSeries>
<SendersTimeSeriesIdentification v="1"/>
<SendersTimeSeriesVersion v="1"/>
<BusinessType v="A06"/>
<Product v="8716867000016"/>
<ObjectAggregation v="A03"/>
<InArea v="10YAL-KESH-----5" codingScheme="A01"/>
<OutArea v="----- " codingScheme="A01"/>
<InParty v="10XAL-KESH-----J" codingScheme="A01"/>
<OutParty v="11XIGET-----D" codingScheme="A01"/>
<MeasurementUnit v="MAË"/>
<Period>
<TimeInterval v="2008-11-18T23:00Z/2008-11-19T23:00Z"/>
<Resolution v="PT15M"/>
<Interval>
    <Pos v="1"/>
    <Qty v="15.0"/>
</Interval>
<Interval>
    <Pos v="2"/>
    <Qty v="15.0"/>
</Interval>
....
<Interval>
    <Pos v="96"/>
    <Qty v="15.0"/>
</Interval>
</Period>
</ScheduleTimeSeries>
</ScheduleMessage>
```

-Intervali kohor si dhe rezolucioni (vlera e energjisë) në procesin e skedulimit ndërkufitar. Interval kohor në skedulimin ndërkufitar do të quhet periudha e cila fillon në 00:00 CTE dhe mbaron në 24:00 CTE. Rezolucioni do të jetë ose orar ose 15 min. Energjia nominohet në MW pa shenja + ose -.

-Përputhshmeria e dokumenteve dhe konfirmimi i procesit të skedulimit ndërkufitar. Procesi duhet të jetë në përputhje me rregullat e ENTSO-E ku rekomandohet se CAS duhet të jenë në përputhshmëri të plotë, nqs nuk janë atëherë në momentin e Cut-Off Time do të aplikohen rregullat për të patur një përputhshmëri të CAS. Procesi i përputhjes është i suksesshëm kur të dy TSO kanë identike si "Titullin e Serive Kohare" (përveç "Identifikimit të serive kohore të Dërguesit" dhe "Versionin") si dhe kur vlerat në interval kohor janë identike. Në rastin kur nuk kemi një shkëmbim identik ndërkufitar me identitetin "Titullin e serive kohore" (përveç "Identifikimit të serive kohore të dërguesit" dhe "Versionit"), shkëmbimi ndërkufitar konsiderohet si pa "homolog". Procesi i përputhshmërisë midis TSO do të jetë ai në mënyrën paralele. Detajet në lidhje me përputhjen duhet të jenë si ato të cilat përmban "Guida e implementimit për proceset v3r3 e ENTSO-E RG CE për ESS ENTSO-E RG CE".

-Për konfirmimin e CAS do të përdoret dokumenti CNF. CNF 'Confirmation Report' raporti i konfirmimit është një lloj raporti i cili përmban të gjitha transaksionet ndërkufitare, bën përputhjen e tyre dhe nëpërmjet tij propozohet zgjidhja në rast kur ka mospërputhje. ACK of CNF – 'Acknowledgement Document' - Dokumenti përmban informacion mbi pranimin ose refuzimin e dokumentit CNF. - Nqs ka një mosdakortësim deri në momentin e 'Cut-Off Time' atëherë TSO bihen dakort me rregullat e mëposhtme në mënyrë që të kemi një 'CAS' të dakortësuar:

- Kur kemi vlera të ndryshme në një segment kohor të caktuar ,atëherë pranohet vlera më e vogël.
- Kur mungojne vlerat ,ateherë vlerat merren zero.

Në këto raste, "Raporti i konfirmimit" përmban si "Seritë kohore" dhe "Seritë kohore" të imponuara sipas këtyre rregullave.

Shembull për CNF e dërguar nga OST:

```
<?xml version="1.0" encoding="utf-8"?>
<ConfirmationReport DtdVersion="3" DtdRelease="3">
  <MessageIdentification v="20171220_CAS-CNF_KS-AL_00002" />
  <MessageType v="A08" />
  <MessageDateTime v="2017-12-19T19:32:53Z" />
  <SenderIdentification v="-----" codingScheme="A01" />
  <SenderRole v="A04" />
  <ReceiverIdentification v="10XAL-KESH-----J" codingScheme="A01" />
  <ReceiverRole v="A04" />
  <ScheduleTimeInterval v="2017-12-19T23:00Z/2017-12-20T23:00Z" />
  <ConfirmedMessageIdentification v="20171220_CAS_AL_KS" />
```

```

<ConfirmedMessageVersion v="2" />
<Domain v="10YDOM-1010A032Z" codingScheme="A01" />
<ProcessType v="A17" />
<Reason>
  <ReasonCode v="A85" />
  <ReasonText v="Confirmation ëithout adjustment (time series have been matched
ëithout change)" />
</Reason>
<TimeSeriesConfirmation>
  <SendersTimeSeriesIdentification v="146438" />
  <SendersTimeSeriesVersion v="2" />
  <BusinessType v="A06" />
  <Product v="8716867000016" />
  <ObjectAggregation v="A03" />
  <InArea v="10YAL-KESH-----5" codingScheme="A01" />
  <OutArea v="-----" codingScheme="A01" />
  <InParty v="22XGSA-----N" codingScheme="A01" />
  <OutParty v="34X-0000000004-P" codingScheme="A01" />
  <MeasurementUnit v="MAW" />
  <Period>
    <TimeInterval v="2017-12-19T23:00Z/2017-12-20T23:00Z" />
    <Resolution v="PT60M" />
    <Interval>
      <Pos v="1" />
      <Qty v="65.000" />
    </Interval>
  </Period>
  ....
</Period>
  <Reason>
    <ReasonCode v="A88" />
    <ReasonText v="Time series matched" />
  </Reason>
</TimeSeriesConfirmation>
</ConfirmationReport>

```

- -Koha e mbylljes se portave per shkembimin e CAS dhe Cut-Off Time.

Lloji i të dhëna / informacion	Afati i fundit	Përpunimi, Konsultimi, Përfundimi
CAS për ditën e caktuar ACK	Gate-Closure Time) Dita D-! deri ne 14:00 (CET)	Dergimi / Marrja e CAS,ACK Kontolli reciprok
Devijimet e identifikuara ndërmjet programeve	D-1 deri ne 14:15 (CET)	Identifikimi i gabimit (eve) Krijimi/Dergimi/Pranimi I CNF Krijimi/Dergimi/Marrja e ACK

"Raporti i konfirmimit", ACK mbi CNF		mbi CNF Ndryshimi dhe ridërgimi i CAS Kontroll reciprok Dërgimi/Marrja e CNF per ditën e caktuar Krijimi/Dërgimi/Marrja e ACK mbi CNF e pranuar.
CNF ACK mbi CNF	Cut-Off Time D-1 deri në 15:00	
Intraday CAS ACK	Dita aktuale ,45 minuta perpara ores tek I cili fillon ndryshimi	-Dërgimi / Marrja e CAS-it të ri që përmban seritë kohore të vjetra dhe të reja (të modifikuara). -Krijimi, dërgimi / marrja e “ACK” për CAS
CNF mbi programin e ndryshuar	Dita aktuale ,30 minuta perpara ores tek I cili fillon ndryshimi	Dërgimi / Marrja e konfirmimit të programit (eve) të ri të dakortësuar.

* Komunikimi për programin ditor ndërkufitar bëhet çdo ditë nga e hëna deri të dielën.

a. Shqipëri-Kosovë

Procesi i ‘Long-Term matching D-2’

Ky proces zhvillohet çdo ditë në orën 08:00-08:30.

- Dokumentet që shkëmbehen janë ‘CAS file’ i cili dërgohet dhe pritët midis OST-KOSTT.
- Shkëmbehen ‘CAS ACK’ për secilin ‘CAS’ respektiv.
- Në rast ‘match’ apo ‘mismatch’ të ‘CAS file’ pritët ‘CAS CNF’ nga KOSTT ,nga ana OST nuk dërgohet ky dokument.
- Në rast ‘match’ në ‘CAS file’ kalohet në krahasimin e ‘CAS CNF’ dhe më pas nëse gjithçka është në rregull kalohet dërgimin nga ana e OST e ‘CAS CNF ACK’ drejt KOSTT dhe këtu mbyllet procesi.
- Në rast ‘mismatch’ procesi ndalon në DAMAS në krahasimin e CAS File dhe nuk vazhdon më tej, nga KOSTT dërgohet ‘CAS CNF’ negative, pasi zgjidhet ky mismatch (në atë anë të kufirit ku duhet bërë ndryshimi apo mungesa e një nominimi qoftë nga ana jonë apo e KOSTT , ridërgohet ‘CAS file’ nga OST apo KOSTT i ri me vlerat e ndryshuara/munguara) dhe procesi vazhdon rregullisht si në rastin kur jemi match.
- Përfundimet e këtij procesi dërgohen nga DAMAS automatikisht në SEECAO në mënyrë që të zhvillohet ankandi ditor për këtë kufi.

Procesi ‘Daily Matching D-1’

Ky proces zhvillohet çdo ditë në orën 14:00-14:30

- Dokumentet që shkëmbehen janë ‘CAS file’ i cili dërgohet dhe pritët ndërmjet OST-KOSTT.
- Shkëmbehen CAS ACK për secilin CAS respektiv.
- Në rast ‘match’ apo ‘mismatch’ të ‘CAS file’ pritët ‘CAS CNF’ nga KOSTT, nga ana e OST nuk dërgohet ky dokument.
- Në rast ‘match’ në ‘CAS file’ kalohet në krahasimin e ‘CAS CNF’ dhe më pas nëse gjithçka është në rregull kalohet në dërgimin nga ana OST e ‘CAS CNF ACK’ drejt KOSTT dhe këtu mbyllet procesi.
- Në përfundim krijohet ‘SAX file’ i cili dërgohet në VP (Verification Platform).

- Në rast ‘mismatch’ procesi ndalon në DAMAS në krahasimin e ‘CAS File’ dhe nuk vazhdon më tej, nga KOSTT dërgohet ‘CAS CNF negative’, pasi zgjidhet ky ‘mismatch’ (në atë anë të kufirit ku duhet bërë ndryshimi apo mungesa e një nominimi qoftë nga ana OST apo e KOSTT , ridërgohet ‘CAS file’ nga OST apo KOSTT i ri me vlerat e ndryshuara/munguara) dhe procesi vazhdon rregullisht si në rastin kur jemi ‘match’.

Procesi ‘Intraday’

Ky proces zhvillohet në D-1 pas orës 18:00 deri në ditën D në orën 22:00

- Dokumentet që shkëmbehen janë ‘CAS file’ i cili dërgohet dhe pritët ndërmjet OST-KOSTT.

- Shkëmbehen CAS ACK për secilin CAS respektiv.

- Në rast ‘match’ apo ‘mismatch’ të ‘CAS file’ pritët ‘CAS CNF’ nga KOSTT, nga ana e OST nuk dërgohet ky dokument.

-Në rast ‘match’ në ‘CAS file’ kalohet në krahasimin e ‘CAS CNF’ dhe më pas nëse gjithçka është në rregull kalohet në dërgimin nga ana OST e ‘CAS CNF ACK’ drejt KOSTT dhe këtu mbyllet procesi.

-Në përfundim krijohet ‘SAX file’ i cili dërgohet në VP (Verification Platform).

- Në rast ‘mismatch’ procesi ndalon në DAMAS në krahasimin e ‘CAS File’ dhe nuk vazhdon më tej, nga KOSTT dërgohet ‘CAS CNF negative’, pasi zgjidhet ky ‘mismatch’ (në atë anë të kufirit ku duhet bërë ndryshimi apo mungesa e një nominimi qoftë nga ana OST apo e KOSTT , ridërgohet ‘CAS file’ nga OST apo KOSTT i ri me vlerat e ndryshuara/munguara) dhe procesi vazhdon rregullisht si në rastin kur jemi ‘match’.

-‘CAS’ përfundimtar përmban të gjitha nominimet si ato të ‘Long Term + Daily + Intraday’

🔧 **Shënim: Administration Console-Process Schedules** –Në konfigurimin me Kosovën të procesit të skedulimit për sa i përket procesit kur aplikohet minimum value rule procesi të konfigurohet sipas mënyrës që përdoret në rajonin CEE.

Cikli i korrigjimit përfundon me kohën e ndërprerjes (COT). Nëse nominimet nuk përputhen me COT, ato modifikohen në përputhje me parimet e mëposhtme:


- Në rast mospërputhjeje, vlerat modifikohen në nivelin të ulët të të dy vlerave
- Nëse nuk ka më mospërputhje dhe e drejta e kapacitetit prapëseprapë tejkalohet, nominimet përkatëse janë ulur pro rata.

Praktika që përdoret në CEE:

Cikli i COT:

- Në ciklin ku COT përputhen, të dy OST dërgojnë dokumentin origjinal CAS - gjithmonë presin që vlerat të përputhen..
- Pas shkëmbimit të dokumentit CAS - Zbulohet mospërputhja
- TSO1 dërgon dokumentin CNF që përmban të gjitha nominimet e konfirmuara dhe për nominimet me mospërputhje me propozimin e modifikimit
 - TSO2: CNF ACK: PRANON MODIFIKIMET E PROPOZUARA
 - Të dy nominimet TSO-ve u modifikuan, nuk është e nevojshme për shkëmbim shtesë të CAS.

2.Procesi i Llogaritjes së Energjisë në kufi ‘ Accounting’



Politika 2 dhe Guida e implementimit për procesin e llogaritjes së energjisë në kufi dhe ‘Settlement’ e përcaktuar nga ENTSO-E RGCE kërkojnë që TSO të ketë rënë dakord

